



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 454 Akti

Nr. 545 Vendimi  
Tiranë, më 30.6.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

|                           |                  |
|---------------------------|------------------|
| <b>Genta Tafa (Bungo)</b> | <b>Kryesuese</b> |
| <b>Lulzim Hamitaj</b>     | <b>Relator</b>   |
| <b>Roland Ilia</b>        | <b>Anëtar</b>    |

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 28.6.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Astrit Halilaj**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi mbi tërësinë e çështjes që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Astrit Halilaj, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 28.6.2022, kërkoi konfirmimin në detyrë,

### VËREN:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit Astrit Halilaj, gjatë periudhës së fillimit të procesit të hetimit administrativ, ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Për shkak të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të prokurorëve dhe gjyqtarëve në Republikën e Shqipërisë”, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Subjekti i rivlerësimit Astrit Halilaj i është nënshtruar procedurave të rivlerësimit, duke u shortuar si subjekt në shortin e hedhur në datën 16.12.2019, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në përputhje me “Rregulloren për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”.

3. Trupi gjykues, me vendimin nr. 1, datë 19.12.2019, vendosi të fillojë një hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Genta Tafa (Bungo). Më tej, të gjithë anëtarët deklaruan mospasjen e konfliktit të interesit. Relatori i çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në nenin 14, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

4. Në zbatim të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit ka nisur procedurat e rivlerësimit, si vijojnë:

- a) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës së pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit nr. 84/2016, pranë ILDKPKI-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 31;
- b) plotësimi dhe dërgimi i deklaratës për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3 të ligjit nr. 84/2016, pranë DSIK-së, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016, sipas nenit 35;
- c) plotësimi dhe dërgimi i formularit të vetëvlerësimit profesional, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, pranë organit të vlerësimit të aftësive profesionale, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi, sipas nenit 41 të ligjit nr. 84/2016.

5. Gjatë hetimit administrativ, dhe konkretisht në datën 10.5.2022, Komisioni, me vendimin nr.\*\*\*, datë 10.5.2022, “Për rishpërndarjen me short të çështjeve të komisioneres Alma Faskaj me cilësinë e anëtarit të trupit gjykues të caktuar me procedurat e shortit të muajit dhjetor 2019”, ka vendosur rishpërndarjen me short të të gjitha çështjeve ku komisionere Alma Faskaj ka qenë

në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues dhe pas procedurës së shortit rezultoi se anëtari zëvendësues për këtë çështje u vendos komisioner Roland Ilia, i cili gjithashtu deklaroi edhe mospasjen e konfliktit të interesit. Me anë të postës elektronike, në datën 12.5.2022 subjekti i rivlerësimit u njoftua për zëvendësimin e anëtarit të trupit gjykues, duke i kërkuar gjithashtu të shprehej lidhur me ekzistencën e konflikti të interesit me anëtarin e ri dhe/ose me dy anëtarët e tjerë. Po në të njëjtën datë, 12.5.2022, subjekti i rivlerësimit konfirmoi mospasjen e ndonjë konflikti interesi me të tre anëtarët e trupit gjykues.

**6.** Pas përfundimit të fazës hetimore mbi rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Astrit Halilaj, me vendimin e ndërmjetëm nr. 2, datë 7.6.2022, trupi gjykues vendosi të mbyllë hetimin administrativ *ex officio* dhe në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 vlerësoi që procesi i rivlerësimit për këtë subjekt të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit të parashikuara nga ligji nr. 84/2016.

**7.** Komisioni, në datën 8.6.2022, e njoftoi subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike mbi rezultatet e hetimit kryesisht dhe e ftoi për t'u njohur me dosjen dhe me provat e administruara prej tij, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe për të paraqitur shpjegimet dhe për të provuar të kundërtën e rezultateve të kristalizuara në fund të hetimit administrativ, duke i dhënë kohë deri më 22.6.2022.

**8.** Subjekti i rivlerësimit u paraqit në ambientet e Komisionit në datën 13.6.2022 dhe ushtroi të drejtën për t'u njohur me dosjen përkatëse të hetimit administrativ. Pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ, subjekti paraqiti brenda afatit të caktuar shpjegimet e tij, duke bashkëlidhur provat mbi rezultatet e hetimit kryesisht. Nga shqyrtimi i këtyre të fundit u konstatua se disa prej dokumenteve të përmendura/cituara në shpjegimet e subjektit nuk gjendeshin bashkëngjitur. Lidhur me këto mangësi u njoftua menjëherë subjekti nëpërmjet postës elektronike, i cili i ka plotësuar në datën 23.6.2022, duke vënë në dispozicion edhe pjesën tjetër të dokumentacionit<sup>1</sup>.

**9.** Komisioni, pasi administroi dhe shqyrtoi shpjegimet e subjektit, konstatoi se nga ana e tij nuk ishin paraqitur kërkesa të natyrës procedurale dhe me vendimin e ndërmjetëm nr. 3, datë 24.6.2022, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Astrit Halilaj në seancë dëgjimore të caktuar në datën 28.6.2022, ora 10:00, duke e njoftuar nëpërmjet postës elektronike, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**10.** Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Astrit Halilaj u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Francesco Ciardi, si dhe me pjesëmarrjen e subjektit të rivlerësimit.

**11.** Në vijim, pasi dëgjoi relacionin, subjekti i rivlerësimit Astrit Halilaj parashitroi shpjegimet përkatëse lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer

---

<sup>1</sup>Në datën 23.6.2022, nëpërmjet postës elektronike, u dërguan nga subjekti dy dokumente, konkretisht deklarata noteriale e datës 17.6.2022 dhe certifikata e familjes Ç.

ndaj tij, duke iu referuar edhe shpjegimeve të paraqitura më herët me shkrim. Në fund të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca dëgjimore e datës 28.6.2022 u mbyll, për të rifilluar më 30.6.2022, për shpalljen e vendimit.

### **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

Subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, duke u përgjigjur në kohë, kur i është kërkuar – sipas parashikimeve të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 – përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

### **IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI**

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (i) provat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (iii) raportin mbi kontrollin e figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (iv) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (v) raportin e përpiluar nga KLP-ja; (vi) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të bëra me anë të komunikimit elektronik; (vii) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative; (viii) argumentimet dhe dokumentacionin e paraqitura në seancën dëgjimore; si dhe (ix) faktet e njohura botërisht.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

Bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, duke konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë ka konsistuar në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuara nga pika 5 e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

## Pasuritë e analizuara

### 1. Banesë private dykatëshe dhe kat nënçati, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë

1. Kjo pasuri është deklaruar nga z. Astrit Halilaj në DIPP-në të vitit 2003<sup>2</sup> si banesë private (1+2) me sip.120 m<sup>2</sup>, me përshkrimin “e ndërtuar vetë në vitin 1994”, me vlerë 2.000.000 lekë. Më pas, në DIPP-në e vitit 2009, subjekti ka deklaruar *investim në ndërtim papafingo në banesën ekzistuese, karabina nënçati*, me vlerë 300.000 lekë. Ndërsa në deklaratën *Vetting*, lidhur me këtë pasuri, ka deklaruar *sipërfaqe trualli 420 m<sup>2</sup> të ndërtuar vetë në vitin 1997 me vlerë përafërsisht 5.000.000 lekë* – por pa e deklaruar burimin e ligjshëm financiar që ka shërbyer për investimin në ndërtimin e saj.
2. Nga analizimi i deklarimeve në DIPP-të, ndër vite, ka rezultuar se subjekti në DIPP-në e vitit 2011 për këtë pasuri ka deklaruar kryerjen e një pagese prej 185.000 lekësh për legalizimin<sup>3</sup>. Nga shqyrtimi i praktikës së legalizimit ka rezultuar se shuma totale prej 400.000 lekësh për blerjen e parcelës ndërtimore prej 300 m<sup>2</sup>, është paguar prej subjektit në *cash* vlera 120.000 lekë dhe në letra me vlerë nominale 280.000 lekë, për të cilat ka bërë me dije se i ka blerë në tregun e lirë kundrejt shumës 15.000 lekë, si dhe 58.587 lekë taksë të ndikimit në infrastrukturë<sup>4</sup>.
3. Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti ka deklaruar legalizimin me anë të lejes nr. \*\*\*, datë 22.12.2011, nga ku sipërfaqja 300 m<sup>2</sup> është përfituar me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 21.6.2011, për kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore me sip. 300 m<sup>2</sup>, me palë shitëse ALUIZNI-n dhe palë blerëse z. Astrit Halilaj, e cila më pas rezulton të jetë regjistruar në ZVRPP-në Tiranë në datën 19.1.2012.
4. ASHK Tirana Jug ka konfirmuar pasurinë në emër të subjektit, të llojit “truall” me sip. 420 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 139.8 m<sup>2</sup>, të ndodhur në z. k. \*\*\*\*, e regjistruar me nr. \*\*\*.
5. Nga dokumentacioni i administruar lidhur me origjinën e kësaj pasurie ka rezultuar se trualli fillimisht është përfituar me anë të kontratës së shitblerjes, datë 25.4.1995, të objektit “ish-stalla e tufëzave të dhenve në Selitë të Vogël të NB Kurorë të Rrethit të Tiranës”, me palë blerëse Astrit Halilaj dhe palë shitëse F. L. Më pas, në datën 15.6.1995, z. Astrit Halilaj ka paraqitur një kërkesë për leje ndërtimi pranë KRRT-së Tiranë, e cila, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.6.1995, i ka dhënë lejen e ndërtimit për rikonstruksion banese. Subjekti, për ndërtimin e saj, ka nënshkruar një kontratë sipërmarrjeje në datën 24.6.1995 me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila ka marrë përsipër që t’i ndërtojë një shtëpi banimi njëkatëshe, por pa specifikuar në të vlerën e ndërtimit.
6. Më pas, subjekti ka paraqitur një kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë sipas praktikës dhe kërkesave të ligjit të zbatuar të kohës për vërtetimin e faktit juridik të ndërtimit të një

<sup>2</sup>Në vitin 2003 z. Astrit Halilaj ka deklaruar si oficer i policisë gjyqësore në Sektorin e Policisë pranë Degës së Tatimeve Tiranë, ndërsa në vitin 2009 ka deklaruar si Drejtor i Përgjithshëm i SHKB-së pranë Ministrisë së Brendshme, deri në datën 16.10.2013, kur edhe rezulton të jetë larguar nga ky funksion publik. Në prill të vitit 2016 është dekretuar si prokuror pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

<sup>3</sup>Ligji nr. 9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” dhe vendimi nr. 646, datë 28.7.2010, i Këshillit të Ministrave.

<sup>4</sup>Përlllogaritur kjo për vlerën e ndërtesës prej 11.717.398 lekësh, për të cilën subjekti ka bërë me dije se është përlllogaritur për sipërfaqen totale të objektit prej 413.56 m<sup>2</sup> me koston e ndërtimit për m<sup>2</sup> në momentin e legalizimit, 28.333 lekë/m<sup>2</sup>.

shtëpie dykatëshe, kërkesë e cila është pranuar me vendimin e gjykatës nr. \*\*\*, datë 28.2.1996. Agjencia Kombëtare e Privatizimit Tiranë i ka shitur z. Astrit Halilaj, me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 24.6.1997, truallin që i përkiste objektit të ndërtuar mbi stallën e tufëzave, kundrejt çmimit 96.000 lekë, pas së cilës është lëshuar vërtetimi i pronësisë për regjistrimin e pasurisë shtëpi dykatëshe të ndodhur në Selitë të Vogël, Tiranë, në emër të subjektit të rivlerësimit.

### **1.1. Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie**

7. Me qëllim për të qartësuar periudhat konkrete të kryerjes së ndërtimeve dhe shpenzimeve përkatëse për secilën periudhë/vit, si dhe burimet financiare përkatëse të përdorura nga subjekti ndër vite, Komisioni, nëpërmjet pyetësorëve nr. 2 , 3 dhe 4 i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime dhe të paraqesë dokumentacionin ligjor për të provuar burimin e ligjshëm financiar të krijimit për investimin e kësaj pasurie, si dhe çdo akt tjetër provues si preventiv/situacion punimesh, fatura apo çdo lloj dokument tjetër për investimin në banesën trekatëshe me sipërfaqe totale ndërtimi 413.56 m<sup>2</sup>.
8. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit është shprehur se nuk disponon ndonjë dokument që të provojë shpenzimet e kryera për këtë investim, por ka bërë me dije se kostoja e ndërtimit është rreth 5.000.000 lekë, duke shpjeguar se fillimisht është ndërtuar një banesë njëkatëshe me sip. 120 m<sup>2</sup> me vlerë rreth 2.000.000 lekë, punimet e së cilës kanë nisur që në vitin 1995 dhe është përfunduar në vitin 1999, më pas, ndër vite, janë ndërtuar kati i dytë dhe papafingo me sipërfaqe të njëjtë. Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të dërguar nga Komisioni, subjekti ka bërë me dije se kati i parë është ndërtuar gjatë vitit 1995 dhe është bërë i banueshëm në vitin 1997 ku është ndërtuar dhe kati i dytë në fazë karabina dhe në vitin 2006 kur subjekti i rivlerësimit ka aplikuar për legalizimin e banesës, ajo ishte e përfunduar si karabina, por kati i tretë ka qenë i papërfunduar ende nga brenda.
9. Nisur nga situata jo e qartë dhe mospërputhjet e konstatuara mes deklarimeve në DIPP-të ndër vite dhe përgjigjeve të pyetësorëve të mëparshëm, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 4, ka rifutuar subjektin e rivlerësimit të jepte shpjegimet e tij. Në përgjigje të sa më sipër, ai është shprehur se në vitin 1997 ishte përfunduar karabinaja e katit të dytë dhe të tretë dhe çatia, por i banueshëm ka qenë vetëm kati i parë.
10. Subjekti ka shpjeguar se ndërtimi i katit të parë, së bashku me arredimin, ka kushtuar 2.000.000 lekë, nga të cilat 1.200.000 lekë ndërtimi, sipas aktit të kolaudimit të bërë nga eksperti i licencuar në datën 5.9.2005<sup>5</sup> dhe 800.000 lekë ka kushtuar arredimi. Ai është shprehur gjithashtu se në vitin 2009 janë bërë investime në katin nënçati dhe në vitin 2014 janë kryer investime të tjera të brendshme dhe kati i dytë dhe papafingo janë bërë të banueshme pas investimit në vitin 2014, duke mos dhënë sërish informacion mbi periudhat konkrete të përfundimit të katit të dytë dhe të tretë dhe as të shpenzimeve përkatëse për investimin.

---

<sup>5</sup>Ky akt kolaudimi është gjithashtu pjesë e dosjes së regjistrimit të pasurisë në ASHK. Në këtë akt është përcaktuar se vlera faktike e punimeve në bazë të situacioneve të shlyera nga investitori është 1.200.000 lekë.

11. Nisur nga mos përcaktimi i periudhave konkrete të ndërtimit/përfundimit të godinës dhe kateve të kësaj banese referuar përgjigjeve jo qartësuese të subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu në mënyrë të pavarur një verifikim nga pamjet satelitore të programit satelitor në *Google Earth Pro*, nga ku duket se gjurma e ndërtimit dhe çatia e godinës nuk kanë ndryshuar, së paku prej vitit 2004, dhe po ashtu, për më tepër, bazuar edhe në dokumentin ligjor të vetëdeklarimit nr. \*\*\* prot., datë 7.9.2006, të kryer nga z. Astrit Halilaj pranë ALUIZNI-t<sup>6</sup>.
12. Për sa më lart, me qëllim verifikimin e kostove të ndërtimit nga viti 1995 e në vijim deri në vitin 2006, kur sipas vetëdeklarimit ka përfunduar ndërtimi i godinës, si dhe nisur nga mungesa e ndonjë dokumentacioni ligjor të paraqitur, për sa i takon periudhës kohore të ndërtimit apo kostot përkatëse të ndërtimit, Komisioni kryesisht kreu verifikimin duke analizuar kostot/n e ndërtimit referuar të dhënave zyrtare të EKB-së ndër vite, për të përcaktuar vlerën totale të ndërtimit të këtij objekti (kati i dytë dhe kati tretë) – përjashtuar katin e parë për të cilën, sipas aktit të kolaudimit, kishte kushtuar 1.200.000 lekë – si dhe në kushtet kur ndërtimi është kryer në mënyrë informale dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të paraqesë asnjë lloj dokumentacioni të kohës për të provuar koston reale apo të përafërt të këtij objekti.
13. Referuar dokumentacionit të disponuar, siç është vendimi datë 28.2.1996, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “për vërtetimin e faktit juridik mbi ekzistencën e një godine dy katëshe”, nga ku në katin e parë ndodhej një kuzhinë, dy dhoma, korridor dhe banjë dhe në katin e dytë ndodhej një kuzhinë, dy dhoma, korridor dhe banjë, me konstruksion mur-tulle e mbuluar me soletë monolite dhe çati, Komisioni krijon bindjen se së paku në këtë vit ndërtimi i katit të dytë nuk ka qenë në fazë karabina, për sa kohë duket se kanë qenë të përfunduara edhe ndarjet e mureve të brendshme të katit të dytë, duke u identifikuar edhe në funksionin e tyre të shfrytëzimit, si kuzhinë, dhomë etj., të evidentuara në vendimin e gjykatës në vitin 1996. Për rrjedhojë, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, kati i parë dhe kati i dytë janë konsideruar të përfunduara deri në shkurt të vitit 1996 dhe kosto e ndërtimit të tyre është konsideruar sipas çmimeve referuar nga EKB-ja për vitin 1995<sup>7</sup>.
14. Lidhur me koston e ndërtimit të katit të parë, Komisioni, nisur nga ekzistenca e një dokumenti të kohës, siç është akti situacionit i punimeve bashkëlidhur praktikës së ASHK-së dhe jo vetëm, ka konsideruar si vlerë financiare të investimit prej 1.200.000 lekësh të përshkruar, ndërsa koston e ndërtimit të katit të dytë e ka përllogaritur në vlerën  $143.98 \text{ m}^2 \times 12.883 \text{ lekë/m}^2 = 1.854.895 \text{ lekë}$ , duke rezultuar një total për dy katet e para në shumën 3.054.895 lekë<sup>8</sup>.
15. Bazuar në deklarinimin e fundit të subjektit të rivlerësimit se deri në vitin 1997 ishte përfunduar edhe kati i tretë por në fazë karabina dhe çatia, Komisioni ka përfshirë në analizë edhe ndërtimin në fazë karabina të këtij kati. Referuar marrëveshjes së datës 17.5.2006, të lidhur

<sup>6</sup>Referuar praktikës së ALUIZNI-t, vetëdeklarimi i subjektit ka pasur nr. \*\*\* prot., datë 7.9.2006, por ky dokument nuk ishte pjesë e praktikës së legalizimit të ardhur nga ASHK-ja.

<sup>7</sup>Vendim nr. 815, datë 9.12.1996, “Për miratimin e vlefave mesatare vjetore të apartamenteve tip në tregun e lirë dhe të vlefës së koeficientit ‘K’” sipas së cilës kosto mesatare e ndërtimit në vitin 1995 në qytetin e Tiranës ka qenë 12.883 lekë/m<sup>2</sup> ndërtimi.

<sup>8</sup>Kjo shumë është ndarë në mënyrë proporcionale në bazë të muajve, duke konsideruar fillimin e punimeve pas marrjes së lejes së ndërtimit në qershor 1995 e deri në shkurt 1996, përkatësisht për 6 dhe 2 muaj.

midis Ministrisë së Financave dhe Shoqatës së Ndërtuesve të Shqipërisë “Për përcaktimin e treguesve minimale për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në ndërtim” në tabelën nr.3 të saj, ndër të tjera, përcaktohet volumi që zënë zërat e punimeve, si vijon: (i) struktura beton- arme zë 36.4% të volumit të punimeve; dhe (ii) vendosje hekur betoni zë 7.7% të volumit të punimeve, në total 44.1% të volumit të punimeve. Për pasojë, Komisioni ka konsideruar shpenzimin e kryer në vitin 1997, përkatësisht për sipërfaqen  $139.8 \text{ m}^2 \times 16.567 \text{ lekë/m}^2 \times 44.1\% = 1.021.385 \text{ lekë}$ .

16. Sa i takon diferencës së punimeve në katin e tretë, Komisioni e ka konsideruar si të përfunduar maksimalisht në gusht të vitit 2006 me një kosto mesatare të ndërtimit të viteve 1998<sup>9</sup> dhe 2006<sup>10</sup>, përkatësisht  $22.647 \text{ lekë/m}^2$  ndërtimi, sipas së cilës duket se për përfundimin e këtij kati janë kryer shpenzime në masën  $139.8 \text{ m}^2 \times 22.647 \text{ lekë/m}^2 \times 55.9\% = 1.769.822 \text{ lekë}$ . Kjo vlerë është shpërndarë në analizën financiare në mënyrë të barabartë mes viteve, përkatësisht prej 204.210 lekësh në vit për periudhën 1998 -2005 dhe 136.142 lekë për vitin 2006. Në përfundim të llogaritjeve të mësipërme, duket se ndërtimi i banesës me një sipërfaqe totale  $413.56 \text{ m}^2$  i ka kushtuar subjektit të rivlerësimit rreth 5.846.101 lekë – vlerë kjo që ka konsideruar kostot e ndërtimit në vite më të hershme se ato të pretenduara dhe që, nëse do të shtrihej në periudha të mëvonshme, do të rezultonte në një vlerë më të lartë.
17. Siç është detajuar në tabelën vijuese, Komisioni ka kryer analizën financiare, duke përfshirë të ardhurat nga pagat<sup>11</sup> të subjektit dhe bashkëshortes<sup>12</sup> së tij, shpenzimet për jetesën, investimin e kryer në ndërtimin e banesës, si dhe shpenzimet për arredimin e saj, në përfundim të së cilës ka rezultuar se për ndërtimin e pasurisë në analizë dhe përbalimin e shpenzimeve të tjera<sup>13</sup> të familjes, z. Astrit Halilaj ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 5.362.867 lekë, gjatë periudhës 1995 – 2002<sup>14</sup>.

<sup>9</sup>Vendim nr. 214, datë 28.4.1999, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banave, të vlerave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit “k”, sipas së cilës kostoja mesatare e ndërtimit në vitin 1998 në qytetin e Tiranës ka qenë  $20.033 \text{ lekë/m}^2$  ndërtimi.

<sup>10</sup>Udhëzim nr. 5, datë 7.9.2006, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banave dhe të koeficientit “k” për vitin 2006, sipas së cilës kostoja mesatare e ndërtimit në vitin 1998 në qytetin e Tiranës ka qenë  $25.262 \text{ lekë/m}^2$  ndërtimi.

<sup>11</sup>Duke zbritur gjendjen e mbetur në llogaritë bankare të pagave, shuma këto të pa tërhequra prej tyre gjatë vitit përkatës. Komisioni nuk ka përfshirë në këtë analizë veprimet bankare me një shumë rreth 27.000 USD, të depozituar prej subjektit të rivlerësimit në llogaritë e tij bankare, pasi kjo shumë do të trajtohet veçmas në vijim të këtij relacioni.

<sup>12</sup>Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit është shprehur se investimi është bërë vetëm nga të ardhurat e tij, ndërsa të ardhurat nga paga e bashkëshortes janë përdorur për shpenzime të jetesës e të tjera deri në vitin 2011. Për shkak të vështirësisë së përlllogaritjes së shpenzimeve të jetesës në vitet përpara 2000, periudhë për të cilën nuk ka të dhëna zyrtare dhe nuk mund të arrihet në një qartësi mbi mënyrën e shpërndarjes së shpenzimeve të jetesës në një familje me ekonomi të përbashkët, Komisioni ka konsideruar në analizë shpenzimet e jetesës sipas standardit të deritanishëm të Komisionit dhe të Kolegjit, nga ku deri në vitin 1999 janë përlllogaritur me 66% të të ardhurave familjare nga pagat dhe nga viti 2000 e në vijim sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT.

<sup>13</sup>Në DIPP-në e vitit 2003 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë automjet tip “Mercedes-Benz”, me vlerë 400.000 lekë, i cili është deklaruar të jetë shitur në vitin 2006 në vlerën 500.000 lekë. Komisioni i është drejtuar DPSHTRR-së për dosjen e plotë të automjetit, e cila, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.3.2022, vuri në dispozicion praktikën e automjetit, nga ku rezulton se ishte blerë nga subjekti në shtetin gjerman në datën 15.4.2003, kundrejt vlerës 1.300 euro dhe është paguar 158.597 lekë për zhdoganim. Në vitin 2006, Komisioni ka njohur si të ardhura me burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D, vetëm shumën e barabartë me çmimin e blerjes dhe të zhdoganimit.

<sup>14</sup> Në vitin 2003, subjekti ka kryer disa depozitime në llogaritë e tij bankare, të cilat do të trajtohen veçmas në vijim dhe, për pasojë, nuk janë përfshirë në llogaritjet e mësipërme.



**Tabela nr. 1 – Analiza e burimeve për ndërtimin e godinës së banimit**

| Viti                            | 1994-1995         | 1996              | 1997              | 1998           | 1999            | 2000            | 2001            | 2002           | 2003           | 2004           | 2005           | 2006           |
|---------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|----------------|-----------------|-----------------|-----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|
| Të ardhura nga paga të vitit    | 175 869           | 113 381           | 523 868           | 409 988        | 290 968         | 399 757         | 177 862         | 519 406        | 879 759        | 1 123 587      | 1 059 700      | 1 328 353      |
| Gjendje në llogari e patërhequr |                   |                   |                   |                |                 |                 |                 |                | -6 967         | -59 365        | -88 010        | -58 034        |
| Shpenzime jetese                | -116 074          | -74 831           | -345 753          | -270 592       | -192 039        | -324 000        | -281 592        | -375 456       | -375 456       | -375 456       | -438 228       | -292 152       |
| Investimi në ndërtim            | -2 291 171        | -763 724          | -1 021 385        | -204 210       | -204 210        | -204 210        | -204 210        | -204 210       | -204 210       | -204 210       | -204 210       | -136 142       |
| Shpenzim për blerjen e truallit |                   |                   | -96 300           |                |                 |                 |                 |                |                |                |                |                |
| Shpenzim për blerjen e mjetit   |                   |                   |                   |                |                 |                 |                 |                | -173 745       |                |                |                |
| Shpenzime arredimi              |                   | -400 000          | -400 000          |                |                 |                 |                 |                |                |                |                |                |
| <b>Rezultati</b>                | <b>-2 231 375</b> | <b>-1 125 174</b> | <b>-1 339 570</b> | <b>-64 814</b> | <b>-105 281</b> | <b>-128 453</b> | <b>-307 940</b> | <b>-60 260</b> | <b>119 381</b> | <b>484 556</b> | <b>329 252</b> | <b>842 025</b> |

18. Në vijim të mbylljes së hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të arritura për sa i takon mungesës së burimeve financiare të ligjshme, si dhe i ka kërkuar subjektit shpjegime lidhur me rezultatet e mëposhtme:

- Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe në DIPP-të ndër vite burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e banesës dykatëshe + kat nënçati, në rrugën “\*\*\*”, Tiranë.
- Duket se ka mospërputhje dhe deklaram kontradiktor sa i përket periudhës së ndërtimit të banesës private dhe shpenzimeve përkatëse mes deklaramit fillestar në DIPP-në e vitit 2003, deklaramit në deklaratën *Vetting* dhe përgjigjeve të subjektit përgjatë procesit të rivlerësimit.
- Duket se subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 5.362.867 lekë, për investimin e kryer në ndërtimin e banesës trekatëshe, përgjatë periudhës 1995 – 2002.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

19. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, ka shpjeguar se godina e banimit është ndërtuar një kat sipas lejes së ndërtimit në vitin 1995, ndërsa në vitin 1997 kishte mbaruar si karabina së bashku me çatinë, ndërkohë që pothuajse ishte përfunduar vetëm kati i parë dhe se kati i dytë dhe papafingo kanë qenë përfunduar deri në vitin 2005, ndërsa në vitin 2014 është përfunduar kati nënçati. Ai ka shpjeguar se në formularin e legalizimit të vitit 2006 banesa ka qenë e përfunduar në dy kate dhe se kjo dallohet nga fotografitë që papafingo është e papërfunduar, për të cilat ka paraqitur një sërë dokumentesh.
20. Gjithashtu, gjatë seancës dëgjimore, subjekti ka pretenduar se përfundimi i punimeve është kryer në vitin 2014 dhe ka kërkuar të merret në konsideratë fakti që kostot e ndërtimit të rishpërndahen deri në vitin 2014, por pa e specifikuar konkretisht sasinë dhe kohë se në cilat vite ishte kryer shpenzimi i shpërndarë – i pretenduar si investim gradual ndër vite. Pas seancës dëgjimore – në përmbushje të kërkesës që i ishte bërë nga trupi gjykues për të mundësuar shpërndarjen dhe përlllogaritjen sa më të saktë të shpenzimeve për këtë pasuri – subjekti ka përcjellë pranë Komisionit, me anë të postës elektronike, formularin e vetëdeklarimit nr. \*\*\*,

prot., datë 7.9.2006, për legalizimin e objektit shtëpi banimi trekatëshe, ku në rubrikën e gjendjes faktike është shënuar “e përfunduar”.

21. Për të provuar se përfundimi i punimeve të ndërtimit të kësaj banese është kryer në vitin 2014, subjekti ka paraqitur gjithashtu kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 30.9.2014, të depozituar në Bashkinë e Tiranës, me objekt “Për kryerje punimesh riparimi lysterje fasade dhe riparim të shkallëve në objektin ekzistues tre kate”, si dhe katër fotografi, të cilat nuk mundësojnë identifikimin e periudhës përkatëse kohore, ndonëse nga përshkrimi i bërë nga subjekti i rivlerësimit në *e-mail*-in e datës 28.6.2022, përmendet viti 2014, si vit i realizimit të fotove të banesës, nga ku me sy të lirë dallohet se dritaret e katit të tretë nuk janë të vendosura.
22. Gjithashtu, bashkëlidhur prapësimeve, subjekti ka paraqitur, veç të tjerash, edhe dy urdhra nr.\*\*\*, datë 18.6.1998, dhe nr. \*\*\*, datë 7.12.1999, të ministrit të Rendit Publik, për shpërblimin e punonjësve që kanë ndihmuar në luftën kundër mallrave kontrabandë, përkatësisht në shumat 100.000 lekë dhe 150.000 lekë, të cilët kanë kërkuar të merren në konsideratë si një e ardhur shtesë, e pa pretenduar më herët.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

23. Trupi gjykues, pasi analizoi shpjegimet dhe pretendimet e subjektit, dokumentacionin e paraqitur prej tij, si dhe shqyrtoi të gjitha të dhënat dhe dokumentet e administruara përgjatë hetimit administrativ nga Komisioni – duke iu referuar edhe jurisprudencës së fundit të Kolegjit, dhe konkretisht vendimeve nr. 6 (JR), datë 17.3.2022 dhe nr. 7 (JR), datë 29.3.2022, lidhur me kostot e llogaritura për ndërtimit – vlerësoi të ripërllogariste kostot e ndërtimit të pasurisë në fjalë, duke zbritur vlerat për fondin rezervë dhe fitimin e planifikuar<sup>15</sup> për ndërtimin e katit të dytë dhe të tretë, për sa kohë, sipas dokumentacionit të administruar, ka rezultuar se kati i parë është ndërtuar nga shoqëria ndërtuese “\*\*\*”.
24. Pas këtij saktësimi, ka rezultuar se kostoja e ndërtimit të kësaj banese do të ishte në total 5.430.364 lekë, çka është e përafërt edhe me vlerën e deklaruar prej subjektit në deklaratën *Vetting* prej 5.000.000 lekësh, e ndarë përkatësisht:
  - a. 1.200.000 lekë për katin e parë;
  - b. 1.691.107 lekë për katin e dytë;
  - c. 2.539.257 lekë për katin e tretë, nga të cilat 931.197 lekë shpenzimi i vitit 1997 për ndërtimin në fazë karabina dhe 1.608.060 lekë<sup>16</sup> shpenzimi për përfundimin e ndërtimit në vitet 1998 - 2006.
25. Gjithashtu, Komisioni ka vlerësuar të përllogarisë në analizën financiare edhe të ardhurat shtesë nga shpërblimet e përfituara nga subjekti në kuadër të luftës ndaj kontrabandës, të pretenduara pas njohjes me rezultatet e hetimit, si më sipër.
26. Si rrjedhojë e sa më sipër, duke përfshirë në analizë financiare këto të ardhura shtesë, dhe në funksion të përllogaritjes së investimit për çdo kat, siç është përshkruar më sipër, për ndërtimin

<sup>15</sup>E barabartë me 8.83% për periudhën 1996 – 1997 dhe për periudhën 1998 – 2006 Komisioni ka përllogaritur një mesatare prej ~ 9.14%.

<sup>16</sup>Duke përfshirë në këtë kosto edhe shpenzimin prej 300.000 lekësh të deklaruar në vitin 2009.

e kësaj banese, ka rezultuar një pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, në masën 4.729.542 lekë – siç është detajuar në tabelën vijuese.

**Tabela nr. 2** – Analiza e burimeve për ndërtimin e godinës së banimit/pas prapësimeve

| Viti                            | 1994-1995         | 1996              | 1997              | 1998          | 1999         | 2000           | 2001            | 2002          | 2003          | 2004           | 2005           | 2006           |
|---------------------------------|-------------------|-------------------|-------------------|---------------|--------------|----------------|-----------------|---------------|---------------|----------------|----------------|----------------|
| Të ardhura nga paga të vitit    | 175,869           | 113,381           | 523,868           | 509,988       | 440,968      | 399,757        | 177,862         | 519,406       | 879,759       | 1,123,587      | 1,059,700      | 1,328,353      |
| Gjendje në llogari e patërhequr |                   |                   |                   |               |              |                |                 |               | -6,967        | -59,365        | -88,010        | -58,034        |
| Shpenzime jetese                | -116,074          | -74,831           | -345,753          | -336,592      | -291,039     | -324,000       | -281,592        | -375,456      | -375,456      | -375,456       | -438,228       | -292,152       |
| Investimi në ndërtim            | -2,168,330        | -722,777          | -931,197          | -145,340      | -145,340     | -145,340       | -145,340        | -145,340      | -145,340      | -145,340       | -145,340       | -145,340       |
| Shpenzim për blerjen e truallit |                   |                   | -96,300           |               |              |                |                 |               |               |                |                |                |
| Shpenzim për blerjen e njetit   |                   |                   |                   |               |              |                |                 |               | -332,342      |                |                |                |
| Shpenzime arredimi              |                   | -400,000          | -400,000          |               |              |                |                 |               |               |                |                |                |
| <b>Rezultati</b>                | <b>-2,108,535</b> | <b>-1,084,227</b> | <b>-1,249,382</b> | <b>28,056</b> | <b>4,589</b> | <b>-69,583</b> | <b>-249,070</b> | <b>-1,390</b> | <b>19,654</b> | <b>543,426</b> | <b>388,122</b> | <b>832,827</b> |

27. Ndërkohë që, në vijim të analizimit të shpjegimeve dhe pretendimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit mbi rishpërndarjen e kostove në kohë për ndërtimin e kësaj banese deri në fund të vitit 2014, Komisioni vëren se nga hetimi administrativ ka rezultuar se së paku dy katet e para të saj kanë qenë të përfunduara në vitin 1996, si dhe kati i tretë ka qenë në gjendje/fazë karabina deri në fund të vitit 1997. Kësisoj, pretendimi i ngritur prej subjektit të rivlerësimit në prapësimet e tij mund të gjente hapësirë vetëm në rishpërndarjen e kostove të përfundimit të ndërtimit të katit të tretë. Nëse do të pranohej ky pretendim për shkak të shtrirjes në një periudhë më të gjatë kohore të përfundimit të katit të tretë deri në vitin 2014 – nisur nga rritja e kostos së ndërtimit me kalimin e viteve – kjo ripërlllogaritje do të çonte në një efekt të kundërt, me shtimin e kostove për këtë kat në shumën 2.777.021 lekë, duke e shtuar kështu koston totale të ndërtimit të kësaj banese në krahasim me atë të përlllogaritur më lart, nga 5.430.364 lekë në 5.668.128 lekë.
28. Trupi gjykues – përpos faktit që subjekti nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit pranë ALUIZNI-t ka deklaruar se në vitin 2006 banesa trekatëshe ka qenë e përfunduar – vlerëson të theksojë faktin se, edhe nëse do të konsiderohej bindës pretendimi për shtrirjen e këtyre punimeve deri në vitin 2014, duke i ripërlllogaritur shpenzimet përkatëse në harkun kohor deri në vitin 2014, sërish subjekti do të rezultonte me një pamjaftueshmëri financiare të ngjashme dhe të konsiderueshme, në masën 4.731.986 lekë<sup>17</sup>, duke mos ndikuar kështu në rezultatin final.
29. Në përfundim lidhur me krijimin e kësaj pasurie, Komisioni vlerëson se subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë për të përmbysur barrën e provës, burimin e ligjshëm të të ardhurave që janë përdorur për ndërtimin e godinës së banimit trekatëshe. Trupi gjykues vlerëson se subjekti e mbart këtë detyrim pavarësisht se pasuria në analizë është krijuar përpara fillimit të detyrës, për sa kohë ka qenë ndër pasuritë e deklaruara prej tij dhe, kësijoj, është objekt vlerësimi e verifikimi të burimit të ligjshëm, në kuadër të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, bazuar në parashikimet e nenit 33 të

<sup>17</sup>Pasi do të ulej balanca negative në periudhën 1996 – 2002, në vlerën -4.442.144 lekë dhe për periudhën 2010 – 2012 do të shtohet balanca negative në vlerën 289.842 lekë.

ligjit nr. 84/2016, për sa kohë ka një mungesë të konsiderueshme të burimeve të ligjshme financiare në masën totale prej 4.729.542 lekësh.

## 2. Apartament banimi dhe vendparkim, në Vlorë

30. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2010<sup>18</sup> si e përfituar me anë të kontratës së premtim shitjes nr. \*\*\*, datë 14.8.2010, me vlerë totale 35.000 euro, për të cilën ishin paguar vetëm dy kështet e para, në shumën totale 20.000 euro, me burim krijimi nga: (i) të ardhurat vjetore; (ii) depozitë bankare pranë “ProCredit Bank”; dhe (iii) hua në shumën 10.000 euro, sipas kontratës noteriale nr. \*\*\*, datë 13.8.2010.
31. Nga shqyrtimi dhe analizimi i DIPP-ve ndër vite, ka rezultuar se në vitin 2010 subjekti nuk ka deklaruar ndonjë detyrim të mbetur pa shlyer ndaj palës shitëse. Në DIPP-në e vitit 2011 ka deklaruar një pagesë kësti të apartamentit në shumën 8.000 euro dhe në rubrikën e detyrimeve ka deklaruar shumën e shlyer deri në atë periudhë prej 28.000 euro dhe detyrim të mbetur 7.000 euro, ndërsa në DIPP-në e vitit 2012 ka deklaruar pagesën prej 5.000 euro, me burim nga të ardhurat personale, si dhe detyrim të pashlyer prej 5.000 euro<sup>19</sup>. Në deklaratën pas largimit nga funksioni në tetor të vitit 2013, subjekti nuk ka deklaruar ndonjë pagesë apo detyrim të mbetur pa shlyer palës shitëse për këtë pasuri.
32. Referuar deklaratës para fillimit të detyrës në vitin 2016, në funksionin e prokurorit, subjekti ka deklaruar pasurinë apartament<sup>20</sup> me sip. 79 m<sup>2</sup>, me vlerë 35.000 euro, si dhe për herë të parë pasurinë e llojit “vendparkim”, me vlerë 5.000 euro. Komisioni ka konstatuar se në këtë deklaratë, si dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar huan e marrë nga kunati i tij F. Ç., si një ndër burimet e krijimit të pasurive në fjalë, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion për të provuar mënyrën dhe kohën e shlyerjes së huas. Për sa i takon mospërputhjes midis burimit të deklaruar në vitin 2010 dhe atij të deklaruar në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka dhënë shpjegime, ndonëse është pyetur nëpërmjet pyetësorit nr. 2.
33. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe atij të ardhur nga ZVRPP/ASHK Vlorë<sup>21</sup>, por edhe nga kontrolli në sistemin *online* multifunksional të ASHK-së për institucionet, nuk është konfirmuar kjo pasuri. Bashkëlidhur deklaratës *Vetting* subjekti i rivlerësimit ka paraqitur një kontratë premtim shitjeje, të nënshkruar ndërmjet palës shitëse së ardhshme, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe palës blerëse së ardhshme, z. Astrit Halilaj, nga ku palët kishin rënë dakord për blerjen e një apartamenti 1+1, në katin e pestë, me sipërfaqe totale 79 m<sup>2</sup>, përfshirë edhe ambientet e përbashkëta prej 11 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 35.000 euro<sup>22</sup>, i cili do të likuidohej sipas kontratës<sup>23</sup>. Për të provuar shlyerjen e detyrimit total, subjekti ka

<sup>18</sup>Në vitin 2010 z. Astrit Halilaj deklaroi si drejtor i SHKB-së në Ministrinë e Brendshme.

<sup>19</sup>Kur sipas llogaritjeve në këtë moment duhet të kishin mbetur vetëm 2.000 euro.

<sup>20</sup>Lidhur me shpenzimet e mobilimit të këtij apartamenti është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ka bërë më dije se *vlera e arredimit të kësaj banese është rreth 450.000 lekë dhe se arredimi është bërë në dy faza, në vitin 2012 në vlerën 250.000 leke dhe në vitin 2014 në vlerën 200.000 lekë.*

<sup>21</sup>Nëpërmjet shkresave nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2020.

<sup>22</sup>Referuar udhëzimit nr. 3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2010”, kosto mesatare për sipërfaqe ndërtimi është 28.772 lekë/m<sup>2</sup>.

<sup>23</sup>Shlyerja e detyrimit do të bëhet, si vijon: (i) 10.000 euro pas nënshkrimit të kontratës; (ii) 10.000 euro brenda datës 30.12.2010; (iii) 10.000 euro në momentin e dorëzimit të apartamentit me punime të përfunduara; dhe (iv) 5.000 euro në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare të shitjes.

paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 25.10.2016, lëshuar nga administratori i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., ku deklarohet se vlera e shitjes së pasurisë apartament është shlyer plotësisht në fund të vitit 2014 dhe se në gusht të vitit 2014 subjekti ka blerë edhe një vendparkim me vlerë 5.000 euro, e likuiduar *cash* nga ky i fundit në momentin e blerjes.

34. Së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka paraqitur kontratën e huas nr. \*\*\*, datë 13.8.2010, të nënshkruar mes tij dhe huadhënësit F. Ç., për marrjen hua të shumës 10.000 euro, me afat shlyerjeje 5-vjeçar, përkatësisht 2.000 euro në vit.

## **2.1 Lidhur me analizën financiare të burimeve të krijimit të pasurisë apartament**

35. Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, duke i kërkuar informacion dhe dokumentacion ligjor lidhur me kryerjen e pagesave për blerjen e pasurisë si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të saj. Në përgjigje të sa më sipër, ai është shprehur se: *“Kësti i parë 20.000 euro është likuiduar në momentin e nënshkrimit të kontratës, me burim nga të ardhurat vjetore, depozitë bankare dhe 10.000 euro marrë hua kumatit F. Ç., sipas kontratës së datës 13.8.2010, një ditë para se të nënshkruhej kontrata për blerjen e apartamentit. Burimi i krijimit të shumës 8.000 euro në vitin 2010 janë të ardhurat personale nga paga ime dhe e bashkëshortes. Të gjitha pagesat janë bërë në cash”*. Po ashtu, ka bërë me dije se: *“... të gjitha detyrimet për blerjen e apartamentit dhe garazhit janë shlyer në vitin 2014, përshkruar edhe në deklaratën noteriale të vitit 2016, pas kësaj periudhe nuk kam pasur më detyrime për të shlyer”*. Ndërkohë, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti është shprehur se kësti i fundit prej 2.000 euro për blerjen e apartamentit është paguar në dhjetor të vitit 2013. Komisioni mori në analizë burimet e krijimit të deklaruara nga subjekti në DIPP-në e vitit 2010, konkretisht, të ardhurat vjetore, huan nga kunati F. Ç. dhe depozitën bankare në “ProCredit Bank”.

### **2.1.1 Hua nga shtetasi F. Ç.**

36. Lidhur me këtë hua, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur, së bashku me kontratën e huas, një lëvizje të një llogarie bankare nga “Raiffeisen Bank” të shtetasit F. Ç., në të cilën janë pasqyruar veprimet e periudhës dhjetor 2009 – shkurt 2011. Nga këto lëvizje kanë rezultuar dy depozitime parash, përkatësisht, 29.103 euro në datën 8.12.2009, me përshkrimin “kalim në llogari extra” dhe 19.800 euro në datën 30.4.2010, me përshkrimin “të ardhura nga biznesi”<sup>24</sup>, si dhe janë evidentuar disa tërheqje parash, kryesisht gjatë periudhës mars – prill 2010 dhe një dërgesë prej 17.000 euro në datën 4.5.2010 në favor të një shtetasi tjetër.
37. Nisur nga sa më sipër, Komisioni, nëpërmjet pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 4, i ka kërkuar subjektit të paraqiste dokumentacionin provues të mënyrës së krijimit të këtyre të ardhurave prej kumatit të tij F. Ç., në përgjigje të së cilave është shprehur se ka dhënë shpjegime shteruese në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ku ka sjellë dokumentacionin për burimin e ligjshëm të të ardhurave të z. S. P., shtetas gjerman, bashkëshorti i motrës së huadhënësit, dokumentacion ky që nuk rezulton të jetë paraqitur prej subjektit në asnjë prej pyetësorëve.

<sup>24</sup> Nga një kërkim i kryer në faqen zyrtare të QKB-së, Komisionit nuk i ka rezultuar ndonjë aktivitet tregtar i regjistruar në emër të shtetasit F. Ç., së paku në vitet 2009 - 2010.

38. Në kushtet kur nga ana e subjektit nuk ishte provuar burimi i ligjshëm i huadhënësit për krijimin e shumës prej 10.000 euro, Komisioni nuk e ka përfshirë këtë hua si një burim të ligjshëm në analizën financiare.
39. Referuar deklaramëve periodike, subjekti ka deklaruar shlyerjet e huas në fjalë, si vijon: (i) 2.000 euro të likuiduar sipas DIPP-së së vitit 2011; (ii) 2.000 euro të likuiduar sipas DIPP-së së vitit 2012; (iii) 2.000 euro sipas deklaratës pas largimit nga funksioni në vitin 2013<sup>25</sup> dhe, për pasojë, nuk ka deklaruar më në lidhje me likuidimin e kësaj huaje. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ai është shprehur se ka likuiduar shumën prej 2.000 euro çdo vit dhe kësti i fundit është shlyer në vitin 2015, por nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion që të provojë kohën dhe/apo mënyrën e shlyerjes së kësteve, si dhe përfundimin e kësaj marrëdhënieje huaje. Për sa i përket mundësisë së subjektit për shlyerjen e kësaj huaje me burime të ligjshme financiare, Komisioni i ka konsideruar të shlyera këstet në fund të secilit vit dhe trajtohen së bashku me pagesat e tjera për blerjen e pasurive në fjalë, në fund të analizimit të të gjitha burimeve.

### 2.1.2 Depozitë bankare në “ProCredit Bank”

40. Nga dokumentacioni i administruar, Komisionit i ka rezultuar se depozita bankare prej 10.000 USD është investuar fillimisht nga subjekti në “ProCredit Bank” në datën 8.7.2003 dhe ka qëndruar e investuar deri në datën 17.11.2006, datë në të cilën është tërhequr shuma prej 6.482 USD (nga ku 482 USD janë interesat e përfituara ndër vite). Shuma e mbetur prej 4.000 USD ka vijuar të qëndrojë në depozitë me afat, deri në datën 7.12.2010, datë në të cilën është tërhequr shuma 4.000 USD dhe interesat e përfituara prej 252 USD.
41. Kjo depozitë është deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2003, në shumën 10.000 USD, me burim nga emigracioni. Subjekti ka shtuar në këtë deklaratë se kjo depozitë – së bashku me një depozitë tjetër prej 17.000 USD në ish-Bankën Amerikane (sot “Intesa Sanpaolo Bank”) – është e vëllezërve të tij S. dhe F. H., emigrantë në Angli, të dërguara *cash* dhe me Western Union dhe se në mungesë të tyre, depozitat figuronin në emër të subjektit.
42. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i është drejtuar subjektit të rivlerësimit për të paraqitur dokumentacionin ligjor që provon dërgimin e këtyre parave prej vëllezërve të tij nga vendi i origjinës, si dhe dokumentacionin ligjor që provon burimin e ligjshëm të të ardhurave të tyre. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti është shprehur se: *“Shuma prej 27.000 USD kanë qenë para të dërguara nga vëllezërit në emigracion në Gjermani dhe me pas në Angli, të cilët kanë punuar për disa vite në emigracion. Ata kanë punuar në sektorin e ndërtimit dhe paratë i kanë dërguar kryesisht me Western Union, por edhe në cash, me persona të besuar, më pas këto para janë depozituar në bankë dhe më pas janë përdorur sipas nevojave për familjen dhe prindërit. Këto depozita kanë qenë të mbyllura përpara se unë të filloja detyrë si prokuror për herë të parë, në prill të vitit 2016. Nga ana ime është kërkuar informacion pranë Western Union, por për shkak të kohës së gjatë prej rreth 20 vitesh nuk është ruajtur dokumentacioni, pasi Western Union ruan dokumentacionin vetëm për një afat 5-vjeçar, bazuar në Ligjin për*

<sup>25</sup>Referuar ligjit nr. 9046, neni 7/1 i ligjit, përcakton se: *“Në deklarinim pas largimit nga funksioni jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesit private, për periudhën nga deklarimi i fundit deri në datën e largimit nga funksioni”.*

bankat. Deklaroj nën përgjegjësinë time se vëllezërit e mi kanë kryer gjithmonë punë të ndershme dhe nuk kanë asnjë rekord kriminal në asnjë shtet”. Në lidhje me këtë deklaram subjekti nuk paraqiti ndonjë dokumentacion provues.

43. Në vijim të hetimit administrativ, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 4, i ri kërkoi subjektit të paraqiste dokumentacionin që provon ligjshmërinë e burimit financiar të të ardhurave të vëllezërve të tij, që kanë mundësuar kursimin e shumës prej 27.000 USD, të deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, si dhe të bënte me dije mbi destinacionin e kësaj shume. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se paratë u janë dorëzuar vëllezërve sipas kontributit të tyre dhe një pjesë është përdorur për pagesën e këstit të parë të apartamentit në Vlorë, duke mos paraqitur sërish asnjë dokumentacion provues lidhur me dërgimin e parave apo me burimin e tyre.
44. Nisur nga sa është shpjeguar nga subjekti, prej tij nuk është deklaruar ndonjë marrëdhënie juridike detyrimi apo dhurimi i shumave të pretenduara si të marra dhe kthyer vëllezërve të tij, referuar përgjigjeve të pyetësorit nr. 4 dhe, për rrjedhojë, deklarimi i subjektit mbetet në nivel deklarativ, për aq kohë sa nuk është provuar me dokumentacion ligjor të kohës dhënia apo kthimi i shumave të pretenduara. Po ashtu, nuk ka rezultuar e provuar me dokumentacion ligjor dërgimi i shumave nga vendi i origjinës prej vëllezërve të subjektit dhe burimi i ligjshëm i krijimit të tyre dhe, për pasojë, Komisioni nuk i ka konsideruar këto depozita të krijuara me burime të ligjshme financiare, përfshirë edhe shumën 4.252 USD e paguar në favor të palës shitëse “\*\*\*\*” sh.p.k., shumë e cila buron nga këto depozita bankare.

### **2.1.3 Të ardhura vjetore**

45. Lidhur me të ardhurat vjetore të deklaruara si burim për blerjen e apartamentit, subjekti nuk ka përcaktuar masën financiare të përdorur nga ky burim për pasurinë në fjalë, por nga totali i shumës së paguar në vitin 2010 prej 20.000 euro duket se shuma 10.000 euro ishte marrë hua dhe rreth 3.200 euro<sup>26</sup> ishin tërhequr nga depozita në “ProCredit Bank dhe, për pasojë, shuma e mbetur për t’u likuiduar nga të ardhurat vjetore në vitin 2010 ka qenë 6.800 euro.
46. Nga analizi i DIPP-ve ndër vite nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar ndonjë gjendje *cash* si të mbartur deri në vitin 2010, që të mund të ishte përdorur për blerjen e apartamentit në analizë. Për rrjedhojë, Komisioni ka analizuar mundësinë e familjes së subjektit për të likuiduar shumën prej 6.800 euro vetëm me të ardhurat e vitit 2010, nga ku ka rezultuar se gjatë vitit 2010 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë realizuar të ardhura në masën 2.579.211 lekë, të cilat duken të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e familjes gjatë vitit 2010 dhe për të kryer pagesën e këstit të apartamentit prej 6.800 euro.
47. Përveç të ardhurave nga pagat, në vitin 2011 subjekti ka deklaruar edhe të ardhura nga shitja e një automjeti të blerë po në atë vit nga Ministria e Brendshme, sipas ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009, “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë” dhe VKM-së Nr. 1242, datë 16.12.2009, “Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës që nxirret në

---

<sup>26</sup>Ekuivalenti i shumës 4.252 USD.

ankand, si dhe mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor”. Në bazë të kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*, datë 21.2.2011, pala shitëse Ministria e Brendshme i ka shitur automjetin e llojit “Mitsubishi Pajero”, me procedurën e ankandit me të drejtë parablerjeje, blerësit Astrit Halilaj kundrejt çmimit 437.500 lekë. Më tej ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ia ka shitur këtë automjet në datën 23.9.2011, me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., kundrejt çmimit 1.200.000 lekë<sup>27</sup>.

48. Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, ka ftuar subjektin të shpjegonte arsyet e shitjes së automjetit brenda vitit me një çmim më të lartë, si dhe të paraqiste dokumentacionin që provon pagimin e detyrimeve përkatëse tatimore për të ardhurat e realizuara nga kjo shitje, për sa i takon diferencës mes çmimit të shitjes dhe blerjes prej 762.500 lekësh. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti është shprehur se çmimi i shitjes ka qenë në përputhje me vlerën e tregut, pasi mjeti ka qenë në gjendje të mirë teknike. Ai ka shtuar se nuk i ka kryer ndonjë shërbim të rëndësishëm mjetit dhe nuk ka paguar ndonjë detyrim tatimor, pasi nuk ka pasur dijeni për një detyrim të tillë.
49. Komisioni vlerëson se të ardhurat në masën 762.500 lekë (si diferencë mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së mjetit) nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm financiar, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë, ndryshe nga parashikimet e ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit nuk ka paguar detyrimet tatimore përkatëse dhe, për pasojë, në analizën financiare, të ardhurat nga kjo shitje janë konsideruar në masën 432.500 lekë, të barabartë me çmimin e blerjes.
50. Në përmbledhje të analizimit të tre burimeve të deklaruara për krijimin e kësaj pasurie, ka rezultuar se për kryerjen e pagesës së apartamentit në analizë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 2.765.749 lekë, sipas detajimit të të dhënave të përpunuara dhe përlllogaritura në tabelën e mëposhtme<sup>28</sup>.

**Tabela nr. 3 – Analiza e burimeve për blerjen e apartamentit**

| Viti                                | 2010              | 2011            | 2012            | 2013          |
|-------------------------------------|-------------------|-----------------|-----------------|---------------|
| Të ardhura të vitit                 | 943 908           | 2 976 655       | 2 140 281       | 2 134 333     |
| Shpenzime të vitit                  |                   | -1 368 145      | -1 138 256      | -1 189 927    |
| Shpenzim për blerjen e apartamentit | -2 776 200        | -1 106 400      | -698 600        | -280 420      |
| Marrë hua nga F. Ç.                 | 0                 |                 |                 |               |
| Tërheqje depozitës nga ProCredit    | 0                 |                 |                 |               |
| Shlyerje të huas ndaj F. Ç.         |                   | -276 600        | -279 440        | -280 420      |
| Shpenzim për blerjen e mjetit       |                   | -437 500        | 0               |               |
| Ndryshimi në gjendjet bankare       |                   | -569 354        | -169 451        | -390 214      |
| <b>Rezultati</b>                    | <b>-1 832 292</b> | <b>-781 344</b> | <b>-145 466</b> | <b>-6 648</b> |

<sup>27</sup>Nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare të llogarive të subjektit të rivlerësimit ka rezultuar se rreth gjashtë muaj përpara nënshkrimit të kontratës së shitjes, në datën 8.3.2011 shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. ka transferuar në llogari të subjektit të rivlerësimit shumën 500.000 lekë, me përshkrimin “derdhur pagesa e makinës”, dhe më pas, në datën 24.3.2011, subjekti ka kryer një depozitim *cash* në llogarinë e tij, në shumën 700.000 lekë.

<sup>28</sup>Në analizën e vitit 2010, Komisioni nuk ka konsideruar si burime të ligjshme financiare huan në masën 10.000 euro dhe tërheqjen nga depozita në “ProCredit Bank”, si dhe ka konsideruar të ardhurat e vitit në masën 6.800 euro (të barabartë me shumën e shpenzuar për pagesën e kështit të këtij viti, me këtë burim) dhe, për pasojë, ka rezultuar një mungesë e burimeve të ligjshme financiare prej 1.832.292 lekësh (e barabartë me shumën prej 13.200 euro të burimeve të sipërcituara). Në tabelën e analizës financiare vjetore viti 2010 rezulton me balancë negative më të ulët, për shkak të konsiderimit të të gjitha të ardhurave të vitit.



## 2.2 Lidhur me analizën financiare të burimeve të krijimit të pasurisë vendparksim

51. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën përpara fillimit të detyrës si prokuror, në vlerën 5.000 euro dhe me burim kursimet e familjes, deklarim i cili është përsëritur edhe në deklaratën *Vetting*. Bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, subjekti i rivlerësimit ka depozituar një deklaratë noteriale të shoqërisë shitëse “\*\*\*” sh.p.k., e cila, ndër të tjera, ka deklaruar se në gusht të vitit 2014, z. Astrit Halilaj ka blerë edhe një vendparksim me vlerë 5.000 euro, shumë kjo e likuiduar *cash* në momentin e blerjes. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni ka ftuar subjektin të paraqesë dokumentacionin ligjor me anë të të cilit është kryer blerja e pasurisë në fjalë, si dhe dokumentacionin që provon kohën dhe mënyrën e kryerjes së pagesës së këtij vendparksimi. Në përgjigjet e tij, subjekti është shprehur se blerja nuk është kryer me kontratë noteriale, pasi është rënë dakord me marrëveshje që kontrata të lidhej në momentin e kalimit të pronësisë së apartamentit.
52. Gjithashtu, subjekti ka shtuar se burimi i krijimit ka qenë nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes, si dhe një shumë rreth 1.400.000 lekë, kaluar bashkëshortes nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. në qershor të vitit 2014, për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës. Komisioni iu drejtua subjektit për të bërë me dije mbi statusin aktual të regjistrimit të kësaj pasurie, i cili, në përgjigje të sa më sipër, është shprehur se në lidhje me blerjen e parkingut është lënë në mirëbesim që kur të hartohet kontrata e shitjes së apartamentit të përfshihet edhe ky vendparksim.
53. Nga dokumentacioni i paraqitur prej subjektit bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.10.2016, ka bërë me dije se bashkëshortja e subjektit ka përfituar në datën 1.6.2014, nga shpërblim page dhe leje të zakonshme, me rastin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës, shumën *neto* prej 1.345.500 lekësh, si dhe një shpërblim page me vendim gjykate<sup>29</sup> në datën 19.1.2016, në shumën 1.560.000 lekë, e patatueshme. Nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare të bashkëshortes së subjektit ka rezultuar se shuma prej 1.345.500 lekësh është transferuar në llogari të saj në datën 3.6.2014. Nga kjo shumë, një pjesë prej 935.000 lekësh është transferuar në llogarinë e depozitës dhe ka qëndruar e investuar së paku deri në shtator të vitit 2014, ndërsa shuma prej 365.000 lekësh është tërhequr prej saj.
54. Komisioni ka kryer analizën financiare të periudhës janar – gusht 2014, duke konsideruar tërheqjet e kryera nga llogaritë bankare të subjektit dhe bashkëshortes përgjatë kësaj periudhe. Po ashtu, janë përlllogaritur shpenzimet e familjes përgjatë së njëjtës periudhë, duke mos përfshirë në këtë llogaritje shpenzimet e arredimit dhe shlyerjen e këstit të huas prej 2.000 euro, për sa kohë nuk mund të përcaktohet një moment i saktë i kryerjes së tyre. Në përfundim

<sup>29</sup>Me qëllim qartësimin mbi përfitimin e dy dëmshpërblimeve për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës në vitin 2014 dhe në vitin 2016 me anë të vendimit të gjykatës, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 4, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqiste vendimin e sipërcituar, si dhe të shpjegonte arsyet e këtyre përfitimeve. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se dëmshpërblimi i parë i dhënë bashkëshortes nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a. ka qenë për mosrespektimin e afatit të njoftimit, sipas nenit 143 të Kodit të Punës dhe shpërblimit për vjetërsi, sipas nenit 145 të Kodit të Punës. Ndërkohë, bashkëshortja e subjektit, me anë të kërkesëpadisë, ka kërkuar dëmshpërblim për zgjidhje të menjëhershme të pajustificuar të kontratës, sipas nenit 155 të Kodit të Punës, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.9.2014. Po ashtu, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të këtij vendimi, me vendimin nr. \*\*\*, datë 19.11.2015.

të sa më sipër, ka rezultuar se për blerjen e vendparkimit në analizë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 134.157 lekë – siç është detajuar në tabelën vijuese.

**Tabela nr. 4** – Analiza e burimeve për blerjen e vendparkimit

|                                 |                 |
|---------------------------------|-----------------|
| Të ardhura janar - gusht 2014   | 1 338 000       |
| Shpenzime janar - gusht 2014    | -771 607        |
| Shpenzim për blerjen e garazhit | -700 550        |
| <b>Rezultati</b>                | <b>-134 157</b> |

55. Në vijim të mbylljes së hetimit administrativ, për sa i takon pasurisë vendparkim, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafin 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të arritura lidhur me mungesën e burimeve financiare të ligjshme, si dhe i ka kërkuar shpjegime mbi rezultatet si më poshtë vijon:

- Duket se ka mospërputhje lidhur me burimin e krijimit të pasurisë apartament të deklaruar në deklaratën *Vetting* – ku janë deklaruar vetëm të ardhurat familjare – krahasuar me atë të deklaruar në DIPP-në e vitit 2010 – në të cilin, përveç kursimeve, është deklaruar si burim krijimi edhe një hua në vlerën 10.000 euro dhe tërheqja e një depozite në “ProCredit Bank”.
- Duket se, deri në këtë fazë të hetimeve, nuk është provuar me dokumentacion ligjor burimi i ligjshëm i të ardhurave të huadhënësit F. Ç. për krijimin e shumës 10.000 euro, të dhëna hua subjektit të rivlerësimit – ndërkohë që është ndryshuar edhe deklarimi i subjektit mbi burimin e të ardhurave të huadhënësit – e, për pasojë, kjo shumë nuk mund të konsiderohet si një burim i ligjshëm financiar.
- Duket se, deri në këtë fazë të hetimeve, nuk është provuar me dokumentacion ligjor burimi i ligjshëm i të ardhurave të vëllezërve të subjektit të rivlerësimit, që kanë mundësuar krijimin e kursimeve në masën 27.000 USD, të depozituara në llogari të subjektit në vitin 2003 – e, për pasojë, edhe shuma prej 4.252 USD që rrjedh nga këto kursime nuk mund të konsiderohet si një burim i ligjshëm financiar.
- Duket se për pagesën e kësteve të pasurisë apartament subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në masën 2.765.749 lekë përgjatë viteve 2010 - 2013.
- Duket se përfitimi shtesë i të ardhurave në masën 762.500 lekë (si diferencë çmim shitje – çmim blerjeje), nga shitja e automjetit të llojit “Mitsubishi Pajero” në vitin 2011, nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë për atë diferencë nuk janë paguar detyrimet tatimore përkatëse.
- Duket se për kryerjen e pagesës së vendparkimit në gusht të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 134.157 lekësh.

## **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

56. Nëpërmjet prapësimeve të paraqitura, subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime lidhur me mospërputhjen e burimit të krijimit të pasurisë apartament të deklaruar në deklaratën *Vetting*, krahasuar me atë të deklaruar në DIPP të vitit 2010, ndërsa përsa i takon huasë në shumën 10.000 euro, ai është shprehur se nëpërmjet pyetësorit nr. 1 ka dhënë shpjegime shteruese në lidhje me burimin e këtyre parave, nëpërmjet deklaratës noteriale dhe të ardhurave të fiskalizuara nga puna në Gjermani të shtetasit S. P. Sipas deklaratës noteriale<sup>30</sup> të bërë para noterit në Gjermani dhe e përkthyer në gjuhën shqipe, shtetasi S. P. i ka dhënë në posedim kumatit të tij F. Ç. shumën prej 30.000 euro për prenotimin e një apartamenti në Shëngjin, nga të cilat i është dhënë hua subjektit shuma 10.000 euro, për blerjen e apartamentit në Vlorë.
57. Subjekti vijon më tej se, duke qenë në dijeni se nga shtetasi F. Ç. zotërohej kjo shumë, i ka kërkuar huan me pëlqimin verbal paraprak z. S. P. dhe, në mungesë të këtij të fundit në Shqipëri, është lidhur kontrata e huas me zotëruesin e parave, shtetasin F. Ç. Në këto rrethana, subjekti ka kërkuar që huaja prej 10.000 euro të njihet si burim i ligjshëm.
58. Përveç sa më sipër, në cilësinë e provës, subjekti ka depozituar disa mandate tërheqjeje parash nga Western Union të dërguara në favor të subjektit nga Belgjika dhe Mbretëria e Bashkuar nga disa shtetas të tjerë, jo vëllezërit e tij, dhe raportet e hyrje-daljeve nga sistemi TIMS për shtetasit F. dhe S. H.<sup>31</sup>. Gjithashtu subjekti ka dërguar<sup>32</sup> një deklaratë noteriale të datës 17.6.2022 të vëllait të tij F. H., i cili ka deklaruar se ka emigruar nga viti 1999 në Gjermani dhe nga viti 2005 e më pas në Britaninë e Madhe dhe se nga puna e ligjshme gjatë këtyre viteve ka fituar të ardhura, të cilat i ka dërguar nëpërmjet personave të ndryshëm, por edhe me Western Union. Ai ka deklaruar se shumatat e dërguara kanë qenë 32.000 USD, të cilat janë investuar për blerjen e dyqaneve në \*\*\* dhe 27.000 USD depozituar nga vëllai i tij Astrit Halilaj në banka të nivelit të dytë, duke shtuar se një pjesë e këtyre të ardhurave janë tërhequr nga ky i fundit, i cili ia ka dorëzuar atij dhe janë përdorur për nevoja familjare. Subjekti ka paraqitur gjithashtu një vërtetim datë 15.11.2016 nga Unioni Financiar Tiranë, në të cilin janë shprehur se të dhënat personale të klientëve mbahen për një periudhë 5-vjeçare dhe më pas fshihen.
59. Gjithashtu, subjekti ka depozituar, në cilësinë e provës, disa urdhra të Ministrisë së Punëve të Brendshme për pjesëmarrjen në trajnime dhe konferenca jashtë vendit, përgjatë periudhës 2010 – 2013, ku shpenzimet janë mbuluar nga organizatorët apo nga institucioni.

## **Vlerësimi i trupit gjykues**

60. Nga shqyrtimi i shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, mbi rezultatet e dërguara nga Komisioni, nuk ka rezultuar që ai të jetë shprehur lidhur me mospërputhjen e konstatuar mbi

---

<sup>30</sup>Ky dokument u dërgua nëpërmjet postës elektronike pas kërkesës, pasi rezultoi se nuk ishte bashkëlidhur prapësimeve të subjektit të rivlerësimit.

<sup>31</sup>Në raportin e shtetasit F. H. ka rezultuar shënimi në datën 29.1.2009 është kthyer i deportuar nga Anglia. Është verifikuar dhe nuk ka rezultuar me probleme dhe është lënë i lirë.

<sup>32</sup>Nëpërmjet postës elektronike datë 23.6.2022, dokumenti deklaratë noteriale i datës 17.6.2022.

burimin e krijimit të deklaruar për këtë pasuri në deklaratën *Vetting*, krahasuar me atë të deklaruar në DIPP-në e vitit 2010.

61. Në vijim të analizimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit si dhe dokumentacionit të administruar lidhur me huanë e marrë prej kunatit të tij, shtetasit F. Ç., Komisioni, fillimisht vlerëson të theksojë se subjekti nuk ka deklaruar/specifikuar në ndonjë prej deklaratave të tij periodike marrjen e huas me burim nga të ardhurat e shtetasit S. P. Pretendimi i subjektit se si burim i huas të marrë nga z. Ç. kanë shërbyer të ardhurat dhe kursimet e z. P., është përmendur për herë të parë në pyetësin nr. 4, si dhe dokumentacioni mbështetës është paraqitur për herë të parë me prapësimet e subjektit.
62. Nisur nga sa më lart, trupi gjykues vlerëson se paraqitja e dokumentacionit të mësipërm, vetëm pas njohjes me rezultatet e hetimit, e bën deklarinim/qëndrimin e subjektit mbi burimin e kësaj huaje kontradiktor dhe jo bindës. Për rrjedhojë, Komisioni vlerësoi që shuma 10.000 euro të mos përfshihet në analizë financiare, për sa kohë nuk është provuar burimi i ligjshëm i huadhënësit.
63. Për sa i takon burimit të ligjshëm të të ardhurave të vëllezërve të subjektit, që kanë mundur krijimin e kursimeve në masën 27.000 USD të depozituara në llogarinë e tij, pjesë e të cilave kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë në analizë, Komisioni vëren se asnjë prej këtyre mandateve nuk rezulton të ketë si dërgues vëllezërit e subjektit të rivlerësimit në rubrikën e dërguesit/ve.
64. Gjithsesi, përpos provës së munguar mbi transferimin drejt Shqipërisë të shumave të pretenduara – për të cilat mund të ketë pasur vështirësi apo pamundësi për sigurimin e provave ligjore – Komisioni vëren se nga ana e subjektit nuk u arrit të provohej, nëpërmjet ndonjë dokumentacioni ligjor, fakti kryesor që lidhet me gjenerimin e të ardhurave të vëllezërve të tij, për të cilat ka pretenduar se ato janë realizuar nga burime të ligjshme dhe se janë përmbushur detyrimet përkatëse tatimore në vendin e krijimit. Madje, subjekti nuk ka provuar as ekzistencën e ndonjë marrëdhënieje pune të vëllezërve të tij në vendet dhe në periudhat e pretenduara. Komisioni vlerëson se deklarimi i vëllait të subjektit F. H. është depozituar vetëm pas dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ, si dhe nuk është i shoqëruar me ndonjë dokumentacion ligjor provues të kohës, për sa i takon sasisë dhe mënyrës së të ardhurave të përfituara nga vëllezërit e subjektit apo të pagesës së detyrimeve tatimore që do t'i bënin ato, një burim të ligjshëm financiar. Në këto kushte, ligjshmëria e këtij burimi financiar mbetet në nivel deklarativ dhe i pambështetur në prova dhe, kështu, nuk mund të konsiderohet dhe përlllogaritet në analizën financiare për këtë pasuri.
65. Nisur nga sa më sipër është përshkruar, Komisioni arrin në përfundimin se nuk është provuar me ndonjë dokumentacion ligjor burimi i ligjshëm i të ardhurave të vëllezërve të subjektit të rivlerësimit, që – sipas subjektit – kanë mundur krijimin e kursimeve në masën 27.000 USD, të depozituara në llogari të subjektit në vitin 2003 dhe, për pasojë, edhe shuma prej 4.252 USD që rrjedh nga këto kursime nuk mund të konsiderohet si një burim i ligjshëm financiar.

66. Gjithsesi, trupi gjykues vlerëson të theksojë se kjo pamundësi financiare – që rrjedh nga mungesa e provës mbi ligjshmërinë e burimit të remitancave të dërguara nga vëllezërit e subjektit – ka një impakt relativ në analizën e kësaj pasurie dhe në vetvete nuk vlerësohet i mjaftueshëm që të përbëjë shkak për masë disiplinore. Komisioni mbërrin në këtë konkluzion duke pasur në vëmendje edhe këto rrethana: (i) në periudhën në fjalë subjekti nuk ka mbuluar një funksion që e bënte atë subjekt deklarues; (ii) shumat e depozituara me këtë burim të pretenduar nuk kanë qenë gjendje si pasuri e disponuar edhe në momentin e kryerjes së deklaratës për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (iii) nga ana e subjektit është deklaruar që prej vitit 2003 në DIPP-në e atij viti se këto shuma i përkasin vëllezërve të tij, të deklaruar prej tij si persona të tjerë të lidhur.
67. Lidhur me shpenzimet për udhëtimet, Komisioni, pasi ka analizuar dhe vlerësuar të bazuara pretendimet e subjektit, ka zbritur shpenzimet e përlllogaritura më herët për disa nga udhëtimet, për të cilat shpenzimet janë mbuluar nga punëdhënësi. Kësisoj, rezultati i analizës financiare është përmirësuar me 136.411 lekë<sup>33</sup>, në raport me rezultatin e njoftuar për këtë pasuri. Në përfundim të analizimit përmbledhës të zërave të mësipërm, të pretenduar si burime krijimi, ka rezultuar se për blerjen e pasurisë së llojit “apartament banimi”, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 2.629.338 lekësh dhe, për pasojë, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë pasuri, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, bazuar në parashikimet e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.
68. Ndërsa lidhur me mungesën e burimeve financiare për blerjen e pasurisë së llojit “vendparkim”, Komisioni vlerëson se, për aq kohë sa nuk janë paraqitur pretendime apo prova për të kundërshtuar/ndryshuar atë, rezultati i njoftuar për këtë pasuri nuk ndryshon, duke mbetur kësijoj një mungesë e burimeve të ligjshme financiare në masën 134.157 lekë, ndonëse në vetvete kjo pamundësi financiare me burime të ligjshme nuk mund të sjellë pasoja.

### 3. Lidhur me dy njësi shërbimi, në Tiranë

69. Këto pasuri (dy njësi shërbimi), për herë të parë, janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën përpara fillimit të detyrës si prokuror në vitin 2016, si pasuri të blera fillimisht nga vëllai i tij F. H., me kontratën e sipërmarrjes së datës 28.9.2000, me vlerë 32.000 USD, me burim nga të ardhurat nga emigracioni dhe më pas janë kaluar të drejtat reale te subjekti sipas aktit noterial nr. \*\*\*, datë 8.9.2014. Ky deklaram është përsëritur edhe në deklaratën *Vetting*, duke shtuar se pronat janë në proces legalizimi pranë ALUIZNI-t.
70. Në mbështetje të deklarimeve të mësipërme, subjekti ka paraqitur bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, një kontratë sipërmarrjeje nr. \*\*\*, datë 28.9.2000, nënshkruar mes shoqërisë sipërmarrëse “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe porositësit F. H., për ndërtimin e një pasurie të llojit “dyqan” me sipërfaqe të përgjithshme 76 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit total 32.000 USD<sup>34</sup>. Nga shqyrtimi i

<sup>33</sup>Sa i takon përfitimit dhe ligjshmërisë së të ardhurave shtesë, në vitin 2011, (mbi diferencën midis çmimit të blerjes dhe atij të shitjes) për automjetin “Mitsubishi Pajero”, për të cilat prej subjektit nuk ishin paguar detyrimet tatimore përkatëse, - ato do të analizohen në vijim, në trajtimin e pasurisë nr. 4 të këtij vendimi.

<sup>34</sup>Në këtë kontratë palët kanë përcaktuar kryerjen e pagesave me këste. Këstet do të paguheshin si vijon: (i) 10.000 USD në momentin e nënshkrimit të kontratës; (ii) 4.000 USD në datën 15.11.2000; (iii) 4.000 USD në datën 15.1.2001; 4.000 USD në datën 15.3.2001; 4.000 USD në datën 15.5.2001 dhe 6.000 USD me marrjen e çelësave në dorëzim.

kontratës së sipërmarrjes së sipërcituar, në pjesën përshkruese të palëve ka rezultuar se për porositesin F. H. është shënuar “me prokurë”, por te nënshkrimi për porositesin ka firmosur subjekti, pa përcaktuar apo bashkëlidhur prokurën apo ekstremitetet e saj.

71. Veç sa më lart, subjekti ka paraqitur bashkëngjitur deklaratës *Vetting* një deklaratë noteriale për heqje dorë nga pronësia me nr. \*\*\*, datë 8.9.2014, të lëshuar nga vëllai i tij, z. F. H.<sup>35</sup>, i cili ka deklaruar se: “Unë heq dorë nga vazhdimi i procedurave të legalizimit të këtyre dy njësive, duke i kaluar këto të drejta në emër të vëllait tim Astrit Halilaj, i cili ka të drejtë të bëjë kalimin e pronësisë së këtyre dy njësive në emër dhe me shpenzimet e tij. Shkaku që unë heq dorë është pasi kemi rënë dakord që këto dy njësi janë pjesë që përfiton Astrit Halilaj nga ndarja e pasurisë së trashëguar dhe të fituar së bashku para vitit 2001<sup>36</sup>”.
72. ZVRPP/ASHK-Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.8.2017 dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2018, kanë konfirmuar pronësinë në emër të z. Astrit Halilaj për pasuritë e llojit njësi shërbimi me sip. 38 m<sup>2</sup>/secila, të regjistruara me nr. pasurie \*\*\* dhe 6\*\*\*, të ndodhura në z. k. \*\*\*. Gjithashtu, ALUIZNI, me shkresën nr. \*\*\*, datë 8.5.2017, ka bërë me dije se në favor të subjektit të rivlerësimit është regjistruar leja e legalizimit nr. \*\*\*, datë 11.4.2017<sup>37</sup>.
73. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, por edhe nga deklarimi në deklaratën *Vetting* të subjektit të rivlerësimit në pasuritë e lartpërmendura, këto njësi janë dhënë me qira nëpërmjet kontratave të qirasë së viteve 2015 dhe 2016<sup>38</sup>. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka bërë me dije se njësitë e shërbimit më parë janë dhënë me qira nga vëllai i tij, duke vënë në dispozicion dy kontrata qiraje të viteve 2012 dhe 2015<sup>39</sup>.

#### **Lidhur me burimin financiar të përdorur për blerjen e këtyre njësive të shërbimit**

74. Për të provuar shlyerjen e detyrimit të pasurive me palën shitëse “\*\*\*\*” subjekti ka paraqitur një dokument të titulluar aktmbarim kontrate të firmosur nga shtetasi E. S. M., në të cilin përshkruhet se z. F. H. ka mbyllur kontratën e shitblerjes për dyqanet nr. 3 dhe nr. 4, por ky vërtetim është pa datë. Për të saktësuar kohën dhe mënyrën e kryerjes së pagesave për blerjen e njësive të shërbimit, të cilat më pas do të kalonin në pronësi të subjektit të rivlerësimit, Komisioni iu drejtua këtij të fundit nëpërmjet pyetësorit nr. 4, për të paraqitur

<sup>35</sup>Për shkak të dhurimit të njësive në analizë, shtetasi F. H., bazuar në pikën 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, konsiderohet person tjetër i lidhur dhe, për pasojë, ai ka detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave.

<sup>36</sup>Komisioni ftoi subjektin e rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, për të bërë me dije mbi pasurinë e trashëguar përpara vitit 2001 dhe ndarjen e tyre, duke paraqitur edhe dokumentacionin përkatës. Subjekti ka shpjeguar se: “Kemi rënë dakord për variantin e kompensimit në natyrë, duke i dhuruar vëllait një sipërfaqe ambienti të njëjtë të përshtatshme për servis makinash ose një apartament banimi në truallin e banesës sime ekzistuese. Janë ofruar disa firma ndërtuese për të lidhur marrëveshje, për të zhvilluar pronën”. Komisioni iu drejtua subjektit me anë të pyetësorit nr. 4, për të qartësuar mbi deklarimin e dhënë nga vëllai i tij në vitin 2014, në përgjigje të tij, ka bërë me dije se: “Dua të theksoj se ideja e kompensimit në natyrë më ka lindur mua kohë pasi është bërë deklarata noteriale. Është një premtim për të ardhmen, në rast se do të zhvillohet prona, truallin në banesën ekzistuese, kjo gjë nuk është formalizuar me ndonjë akt noterial, por thjesht një premtim verbal”.

<sup>37</sup>Regjistruar këto pasuri bazuar në VKM-në nr. 439, datë 2.7.2014, “Për përcaktimin e procedurave të legalizimit të ndërtimeve pa leje, shtesave anësore apo në lartësi, të ndërtuara nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.”, i ndryshuar, për objektin njësi shërbimi \*\*\* nr. \*\*\*, \*\*\*, me sipërfaqe ndërtimi 76 m<sup>2</sup>.

<sup>38</sup>Ministria e Drejtësisë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.3.2020, ka konfirmuar nënshkrimin e kontratave të qirasë, kontrata të cilat janë administruar nga Komisioni. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se nuk ka asnjë marrëdhënie shoqërore me asnjë nga palët qiramarrëse.

<sup>39</sup>Kontratë qiraje e lidhur me datë 15.2.2012 me shtetasin B. O. dhe kontratë qiraje e lidhur me datë 16.1.2015 me shoqërinë tregtare autoshkolla “\*\*\*\*” sh.p.k., për ushtrimin e aktivitetit.

dokumentacionin përkatës. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti vuri në dispozicion mandatpagesat<sup>40</sup>, ku në total, shuma e paguar është 26.000 USD.

75. Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit për blerjen e pasurive dy njësi shërbimi të deklaruara si pasuri në deklaratën *Vetting*, Komisioni iu drejtua subjektit nëpërmjet pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 4, duke i kërkuar të paraqiste dokumentacionin për krijimin e shumës 32.000 USD për blerjen e tyre. Në përgjigje të pyetësorëve subjekti ka shpjeguar se: “*Burimi i krijimit të të ardhurave prej 32.000 USD për blerjen e njërive të shërbimit nga shoqëria ‘\*\*\*\*’ sh.p.k. është puna në emigracion e vëllait F. H., përgjatë viteve 1999, 2000 dhe 2001, i cili ka punuar në Gjermani. Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, më shumë se 20 vjet, nuk mund të sigurohen dokumente provuese nga autoritet gjermane. Paratë janë krijuar nga puna e ndershme dhe janë transferuar në Shqipëri me persona të besuar dhe me Western Union*”.
76. Në përfundim të sa më sipër, në mungesë të ndonjë dokumentacioni të kohës që të provojë dërgimin e parave nga vendi i origjinës, si dhe të dokumentacionit që të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave nga emigracioni të vëllezërve, të cilat kanë mundur më pas blerjen e pasurive në analizë, duket se pretendimet e subjektit të rivlerësimit për dërgimin e parave mbeten në nivel deklarativ.
77. Në vijim të mbylljes së hetimit administrativ, sa i takon këtyre pasurive njësi shërbimi, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të paraqitur dokumente ligjore për të provuar të kundërtën e rezultateve të arritura si vijon:
- Duket se deri në këtë fazë të hetimeve nuk është provuar me dokumentacion ligjor burimi i ligjshëm i të ardhurave për blerjen e njërive në shumën 32.000 USD.

#### **Qëndrimi i subjekti të rivlerësimit**

78. Subjekti i rivlerësimit, pasi u njoh me rezultatet e hetimit administrativ të njoftuara nga Komisioni, nuk ka dhënë shpjegime shtesë përpos atyre të dhëna përgjatë procesit të rivlerësimit – por ka depozituar një deklaratë noteriale të datës 17.6.2022 të vëllait të tij, e cila është trajtuar më lart – dhe nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion tjetër për të provuar ligjshmërinë e burimeve financiare prej 32.000 USD.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

79. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit – ndonëse i kishte kaluar barra e provës mbi mjetet financiare të përdorura për krijimin e këtyre pasurive – nuk arriti të shpjegojë e provojë në mënyrë shteruese e bindëse dhe nuk paraqiti ndonjë dokumentacion ligjor, në mënyrë që të provonte ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të krijuara nga vëllezërit e tij për blerjen e pasurive njësi shërbimi, në shumën 32.000 USD, të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit si pasuri në deklaratën *Vetting*.

---

<sup>40</sup>Mandatpagesat dhe shumat e paguara si vijon: (i) 6.000 USD, klienti F. H., datë 22.9.2000; (ii) 4.000 USD, klienti F. H., datë 26.9.2000; (iii) 4.000 USD, klienti F. H., datë 23.11.2000; (iv) 4.000 USD, klienti F. H., datë 19.2.2001; (v) 4.000 USD, klienti F. H., datë 17.4.2001; (vi) 4.000 USD, klienti F. H., datë 26.9.2001. ndërsa për sa i takon pagesës së këstit të fundit, ai ka shpjeguar se është paguar në datën 8.12.2001, por nuk disponon mandatpagesë.

80. Nisur nga fakti që këto dy njësi shërbimi janë deklaruar nga subjekti, në funksion të rivlerësimit kalimtar, pasi ato prej shumë vitesh janë përfituar prej tij pa kundërshtim, si dhe janë regjistruar në emër të subjektit, i cili ka gëzuar dhe vijon të gëzojë plotësisht të drejtat reale relative – nëpërmjet dhënies së tyre me qira – Komisioni vlerëson se në këto kushte subjekti mbart detyrimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive, sikurse nuk mund të përjashtohet nga efektet që passjell mospërbushja e këtij detyrimi, apo dështimi për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive që posedon e gëzon. Për pasojë, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, edhe lidhur me këto pasuri, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, bazuar në parashikimet e nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

#### 4. Automjet tip “Mercedes-Benz”

81. Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti në deklaratën përpara fillimit të detyrës si prokuror në vitin 2016, blerë në datën 3.4.2016, me vlerë 6.000 euro dhe 180.000 lekë taksë doganore, me burim nga të ardhurat nga shitja e automjetit me targa \*\*\*, sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 23.9.2013. Nga dokumentacioni dhe informacioni i përcjellë nga DPSHTRR-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.7.2017, është bërë me dije se në emër të subjektit figuron i regjistruar automjeti me targa \*\*\* dhe deri më 15.5.2012 ka qenë regjistruar automjeti me targa \*\*\*. Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2020, DPSHTRR-ja ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen e automjetit në analizë, përfshirë faturën e shitjes në gjuhën gjermane, sipas së cilës shtetasi S. P. i ka shitur subjektin të rivlerësimit automjetin tip “Mercedes-Benz”, e llojit E 220 CDI, vit prodhimi 2007, në shumën 6.000 euro. Subjekti i rivlerësimit ka kryer edhe zhdoganimin e tij, në datën 4.5.2016, kundrejt tarifës 179.201 lekë, nga ku investimi total i subjektit për këtë pasuri ka qenë në vlerën 990.821 lekë.

82. Nga shqyrtimi i dokumentacionit ka rezultuar se shitja e automjetit, ku të ardhurat nga kjo shitje janë deklaruar si burim krijimi për automjetin në analizë, nuk është bërë në vitin 2013, por në vitin 2011, ndërsa referuar shqyrtimit të llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar se shuma e përfituar nga shitja e automjetit të sipërcituar prej 1.200.000 lekësh është transferuar nga subjekti në llogarinë e tij të kursimit në datën 10.6.2011 dhe është tërhequr më pas prej tij përgjatë periudhës 9.12.2014 - 2.2.2015. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti dhe ligjshmërisë së tyre, kjo çështje është trajtuar më lart, ku është njohur si e ardhur me burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, vetëm shuma 432.500 lekë.

83. Në vijim të sa më sipër – nisur nga deklarimi i subjektit në deklaratën *Vetting* mbi burimin e të ardhurave të përdorura për blerjen e pasurisë në analizë për blerjen e kësaj pasurie – subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 558.321 lekësh.

**Tabela nr. 5 – Analiza e burimeve për blerjen e automjetit**

|  |                  |
|--|------------------|
| Të ardhura nga shitja e automjetit ekzistues | 432 500          |
| Shpenzim për blerjen e automjetit të ri      | - 990 821        |
| <b>Rezultati</b>                             | <b>- 558 321</b> |



84. Nga sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektin barrën e provës për të paraqitur dokumente ligjore për të provuar të kundërtën e rezultateve lidhur me këtë pasuri.

- Duket se për blerjen e automjetit në analizë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej 558.321 lekësh.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

85. Në shpjegimet e dërguara, subjekti i rivlerësimit është shprehur se automjeti i mëparshëm tip “Mitsubishi Pajero” ishte përfituar prej tij me një procedurë të rregullt ankandi nga Ministria e Brendshme. Fakti që për pjesën e fituar nuk janë paguar taksa, kjo nuk e bën transaksionin e paligjshëm apo të palogjikshëm për faktin se nuk ka pasur dijeni dhe nuk ka qenë subjekt tatimpagues në kuptim të ligjit për procedurat tatimore, por thjesht një individ dhe transaksioni është kryer nëpërmjet bankës. Gjithashtu, ai ka paraqitur në cilësinë e provës një printim të një faqeje interneti, në të cilën një automjet tip “Mitsubishi Pajero” i vitit 2004 shitet për një çmim prej 11.990 USD.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

86. Referuar shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se rezultati i njoftuar subjektit nuk ndryshon, pasi edhe pse blerja e automjetit është kryer me një çmim preferencial (për shkak të funksionit publik që mbante në Ministrinë e Brendshme) dhe është shitur me çmimin e tregut, subjekti ka pasur detyrimin për të paguar tatimin mbi të ardhurat e realizuara nga kjo shitje dhe fakti i mospagimit të tatimeve mbi vlerën e shtuar (çmim shitje – çmim blerje) nuk e mundëson konsiderimin e kësaj të ardhure si një burim financiar të ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – ndonëse gjenerimi i kësaj shume nga shitja e automjetit tip “Mitsubishi Pajero” është e provuar.

87. Gjithsesi, Komisioni vlerëson se, nisur nga fakti që pamundësia financiare me burime të ligjshme për këtë pasuri është relativisht e ulët, si dhe duke mbajtur parasysh se mjetet monetare të përdorura në këtë rast nuk kanë mbetur të paidentifikuara, pasi kanë rrjedhur nga një shitje pasurie (edhe pse ato nuk mund të kualifikohen në tërësinë e tyre si një burim i ligjshëm – si më lart), pamjaftueshmëria e konstatuar për këtë automjet nuk mund të përbëjë një shkak penalizues për subjektin e rivlerësimit.

#### **5. Automjet tip “Volkswagen”**

88. Ky automjet është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2009, me vlerë 500.000 lekë, por pa deklaruar burimin e krijimit. Kjo pasuri është deklaruar më pas edhe në deklaratën e personit të lidhur te deklarata përpara fillimit të detyrës në vitin 2016, me burim nga kursimet si punonjëse pranë shoqërisë “\*\*\*\*” sh.a., deklarim ky i bërë edhe në deklaratën *Vetting*.

89. DPSHTRR-ja, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2020, ka konfirmuar se në pronësi të shtetases Sh. H., bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, figuron i regjistruar automjeti tip “Volkswagen Golf”, i vitit të prodhimit 1999, me targa \*\*\*, duke vënë në dispozicion edhe dosjen e tij. Automjeti ka hyrë për herë të parë në Shqipëri në vitin 2009 dhe është blerë nga

bashkëshortja e subjektit sipas faturës së shitjes në gjuhën gjermane, të datës 12.10.2009, kundrejt çmimit 1.900 euro, për të cilin është kryer zhdoganimi kundrejt tarifës 237.434 lekë.

90. Lidhur me diferencën mes çmimit të deklaruar prej subjektit dhe çmimit që ka rezultuar nga fatura e shitblerjes, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, në përgjigje të të cilit, subjekti ka bërë me dije se *automjeti i regjistruar në emër të bashkëshortes ka kushtuar 500.000 lekë, duke përfshirë çmimin e blerjes 1.900 euro plus taksën e zhdoganimit*, të cilat nga përlllogaritjet rezultuan në masën 498.057 lekë. Komisioni ka kryer analizën financiare, duke përfshirë të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortes deri në datën e blerjes së automjetit, si dhe shpenzimet e familjes për të njëjtën periudhë, në përfundim të së cilës ka rezultuar se ata kishin mundësi për blerjen e tij, me burime të ligjshme financiare.

**Tabela nr. 6 – Analiza e burimeve për blerjen e automjetit**

|                                   |                |
|-----------------------------------|----------------|
| Të ardhura janar - 14 tetor 2009  | 1 774 000      |
| Shpenzime janar - 14 tetor 2009   | - 691 154      |
| Shpenzim për blerjen e automjetit | - 498 057      |
| <b>Rezultati</b>                  | <b>584 789</b> |

91. Rrjedhimisht, Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri.

#### **6. Gjendje cash jashtë sistemit bankar në masën 900.000 lekë**

92. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndonjë gjendje të disponuar *cash* në banesë, deri në deklaratën përpara fillimit të detyrës si prokuror në vitin 2016, në të cilën subjekti ka deklaruar shumën 900.000 lekë dhe bashkëshortja e tij shumën 500.000 lekë. Në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* me vlerë 500.000 lekë, për arredime dhe shpenzime për nevoja familjare. Më pas, në deklaratën *Vetting* ka deklaruar gjendjen e kursimeve të disponuara *cash* në banesë, në masën 900.000 lekë.
93. Nëpërmjet pyetësorit nr. 4, Komisioni i ka kërkuar subjektit të bëjë me dije mbi burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e këtyre kursimeve dhe, në përgjigjet e tij, subjekti është shprehur se për krijimin e kursimeve *cash* kanë shërbyer të ardhurat nga pagat dhe nga shpërblimet të tij dhe të bashkëshortes. Nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit është larguar nga detyra e mëparshme në tetor të vitit 2013, periudhë pas së cilës nuk ka deklaruar më deri në prill të vitit 2016, analiza financiare për krijimin e kursimeve *cash* deri në fillimin e detyrës së re është kryer në mënyrë kumulative duke filluar nga viti 2014.
94. Në përfundim të kësaj analize, duket se për krijimin e kursimeve *cash* me vlerë 1.400.000 lekë subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për krijimin me burime të ligjshme financiare<sup>41</sup>.

<sup>41</sup>Në këtë analizë nuk është përfshirë investimi i subjektit të rivlerësimit në automjetin e blerë në muajin prill, për sa kohë për blerjen e tij janë pretenduar përdorimi i të ardhurave të mëparshme të vitit 2011, nga shitja e automjetit ekzistues. Në tabelën e analizës financiare, viti rezulton negativ me vlerë 647.935 lekë, pasi në të është përfshirë edhe automjeti i sipërcituar.

**Tabela nr. 7** – Analiza e burimeve për krijimin e kursimeve *cash*

|  |                |
|--|----------------|
| Të ardhura të vitit 2014                   | 3 067 284      |
| Shpenzime të vitit 2014                    | - 1 482 037    |
| Shpenzim për blerjen e vendparkimit        | - 700 550      |
| Gjendje e likuiditeteve janar 2014         | 2 612 609      |
| Gjendje e likuiditeteve dhjetor 2014       | - 3 217 085    |
| Shlyer detyrimi ndaj huadhënësit           | - 280 220      |
| Të ardhura të vitit 2015                   | 810 727        |
| Shpenzime të vitit 2015                    | - 1 173 875    |
| Gjendje e likuiditeteve janar 2015         | 3 217 085      |
| Gjendje e likuiditeteve dhjetor 2015       | - 1 163 942    |
| Shlyer detyrimi ndaj huadhënësit           | - 275 300      |
| Kthyer vëllezërve nga depozitat            | - 1 414 695    |
| Të ardhura të periudhës janar - prill 2016 | 2 084 002      |
| Shpenzime të periudhës janar - prill 2016  | - 320 220      |
| Gjendje e likuiditeteve janar 2016         | 1 163 942      |
| Gjendje e bankave prill 2016               | - 1 184 838    |
| Krijimi kursimeve cash                     | - 1 400 000    |
| <b>Rezultati</b>                           | <b>342 888</b> |

95. Nga sa më sipër ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për krijimin e kursimeve *cash* me vlerë 1.400.000 lekë dhe, rrjedhimisht, Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me këtë pasuri.

#### **7. Gjendje në llogari të subjektit në masën 1.522.532 lekë, në “Raiffeisen Bank”**

96. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se subjekti ka deklaruar gjendjen 1.522.532 lekë, e disponueshme në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank”, në datën 23.1.2017, shumë e cila ka qenë e përbërë nga 1.402.532 lekë gjendje dhe 120.000 lekë limiti i *overdraft*-it. Nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare në llogarinë e subjektit ka rezultuar se shuma 1.402.532 lekë është krijuar nga transferimi i dëmshpërblimeve<sup>42</sup>. Sa i përket dëmshpërblimit prej shoqërisë së sigurimeve “\*\*\*\*” sh. a., subjekti ka paraqitur, së bashku me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, marrëveshjen nr. \*\*\*, datë 22.11.2016, për zgjidhjen jashtë gjyqësisht dhe pranimin e vlerës së shpërblimit, sipas së cilës shoqëria e sigurimeve, pasi ka analizuar dëmin shëndetësor, ka marrë përsipër të paguajë shumën 300.000 lekë në favor të subjektit të rivlerësimit Astrit Halilaj.

97. Sa i përket dëmshpërblimit për shkak të shpërblimit të marrëdhënies së punës, subjekti ka paraqitur së bashku me përgjigjet e pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 4 vendimin nr. \*\*\*, datë 8.10.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, sipas të cilit është vendosur

<sup>42</sup>Transferimi i shumave : (i) shuma 300.000 lekë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.a., në datën 6.12.2016, me përshkrimin “likuidim dëmi”; dhe (ii) shuma 1.311.360 lekë, në datën 22.12.2016, dëmshpërblim page për shkak të shpërblimit të marrëdhënies së punës.

detyrimi i të paditurit Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të dëmshpërblyer paditësin Astrit Halilaj, me 12 paga mujore<sup>43</sup>. Nga shqyrtimi i llogarive bankare të tjera të subjektit ka rezultuar se në “Raiffeisen Bank” ka pasur, gjithashtu, një llogari kursimi, e cila në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting* ka pasur një gjendje prej 24.996 lekësh, llogari kjo e padëklaruar prej subjektit, ndonëse nuk ka rezultuar ndonjë problematikë lidhur me burimin e krijimit të saj, pasi kjo llogari kursimi është furnizuar me të ardhurat e tij nga paga.

98. Nga sa më sipër, në përfundim, ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimet e ligjshme për krijimin e gjendjes në llogarinë bankare në analizë.

#### **8. Gjendje në masën 20.435 lekë, në llogari të bashkëshortes, në “Raiffeisen Bank”**

99. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen e disponueshme prej 20.435 lekësh në llogarinë e bashkëshortes, person fizik, në “Raiffeisen Bank”, shumë kjo e krijuar nga të ardhurat nga aktiviteti.

100. Pasi Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin e administruar dhe ka kryer verifikimet përkatëse ka rezultuar se nuk janë konstatuar problematika lidhur me burimet e ligjshme për krijimin e gjendjes në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit.

### **REZULTATET SIPAS ANALIZËS FINANCIARE**

101. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike ndër vite të subjektit të rivlerësimit, pas përlllogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve në tabelën që i bashkëngjitet këtij dokumenti, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet, detyrimet dhe nga përlllogaritja krahasimore e tyre vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

102. Në këtë analizë ishin konsideruar dhe përpunuar të dhënat financiare, duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti, në ILDKPKI, deri në vitin 2016, nga ku ka rezultuar një bilanc negativ prej 5.255.034 lekësh dhe për periudhën 1995 – 2003 ka rezultuar një bilanc negativ prej 5.362.867 lekësh<sup>44</sup>, për të cilët Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të njoftuara.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

103. Subjekti është shprehur se nëse do të merren në konsideratë prapësimet e tij – të sipërpërkshkruara e trajtuara në lidhje me secilën pasuri veçmas – do të ulej ndjeshëm balanca negative. Përpos pretendimeve të trajtuara më lart (huaja 10.000 euro, vlera 32.000 USD nga vëllezërit dhe depozitat 27.000 USD të vëllezërve), subjekti ka kërkuar që t’i përlllogariten në analizë financiare disa të ardhura nga aktiviteti i bashkëshortes për vitet 2015 dhe 2016, si dhe ka kërkuar që udhëtimet e tij me dalje në Kosovë të konsiderohen si udhëtime me

<sup>43</sup>Gjithashtu, subjekti ka paraqitur edhe dispozitivin e vendimit nr. \*\*\*, datë 27.10.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, sipas së cilit është vendosur lënia e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë për të dëmshpërblyer z. Astrit Halilaj, me 12 paga mujore.

<sup>44</sup>Me një balancë negative totale prej 10.617.901 lekësh.

destinacion Tropojën dhe të përlogaritjet vetëm shpenzimi i transportit, pasi qëndrimi i tij në destinacion është mbuluar nga pritësit.

104. Në seancën dëgjimore subjekti ka paraqitur, ndër të tjera, një *e-mail* (jozyrtar) nga përgjegjësi i sektorit të financës në Ministrinë e Punëve të Brendshme lidhur me disa udhëtime të kryera nga subjekti në kuadër të detyrës së mbajtur prej tij më herët, gjatë viteve 2006 - 2009, shpenzimet e të cilave janë mbuluar nga punëdhënësi.

### Vlerësimi i trupit gjykues

105. Në lidhje me sa është pretenduar nga subjekti i rivlerësimit mbi të ardhurat shtesë të bashkëshortes nga aktiviteti, Komisioni vëren se ishin të përfshira në analizën financiare të dërguar me rezultatet e hetimit. Gjithashtu edhe udhëtimet me destinacion Tropojën janë përlogaritur sipas kërkesës së subjektit.

106. Ndërsa, sa i përket udhëtimeve të subjektit të kryera për shkak të detyrës së periudhës 2006 – 2009, ndonëse dokumenti i paraqitur prej subjektit nuk është i firmosur apo vulosur nga institucioni përkatës, Komisioni vlerëson të pranojë kërkesën e tij, por vlen të theksohet se kjo rrethanë nuk impakton rezultatit final të analizës financiare, duke qenë se analiza e këtyre viteve ka rezultuar me balancë pozitive.

107. Në përfundim të analizimit të pretendimeve të subjektit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe pas reflektimit në analizën financiare të disa ndryshimeve që rridhnin prej tyre – në raport me rezultat e njoftuara – në përfundim ka rezultuar një balancë negative prej 4.729.542 lekësh për periudhën përpara vitit 2003, ndërsa për periudhën 2003 – 2016 ka rezultuar një balancë negative prej 5.002.460 lekë, sikurse janë pasqyruar në detaje në tabelën vijuese.

**Tabela nr. 8 – Analiza financiare për periudhën 1995 – 2016**

| Viti   | Deri 2003        | 2003             | 2004             | 2005              | 2006             | 2007             | 2008             | 2009             | 2010             | 2011              | 2012             | 2013             | 2014             | 2015              | janar - 22 prill 2016 | 22 prill - dhjetor 2016 |
|--|------------------|------------------|------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|-------------------|------------------|------------------|------------------|-------------------|-----------------------|-------------------------|
| <b>PASURI</b>                                | <b>4,549,004</b> | <b>3,331,244</b> | <b>-173,301</b>  | <b>-339,730</b>   | <b>-715,793</b>  | <b>-36,007</b>   | <b>312,828</b>   | <b>1,065,384</b> | <b>4,213,044</b> | <b>1,006,854</b>  | <b>169,451</b>   | <b>390,214</b>   | <b>1,305,027</b> | <b>-2,053,144</b> | <b>2,232,516</b>      | <b>-107,971</b>         |
| Banesë 2 kate dhe nënçati (ndërtuar në 1997) | 4,549,004        | 145,340          | 145,340          | 145,340           | 145,340          |                  |                  | 300,000          |                  |                   |                  |                  |                  |                   |                       |                         |
| Automjet Mercedes Benz 200                   |                  | 173,745          |                  |                   |                  |                  |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                   |                       |                         |
| Apartament në Vlorë                          |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  | 4,858,350        |                   |                  |                  |                  |                   |                       |                         |
| Automjet VW Golf (b/sh)                      |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  | 260,623          |                  |                   |                  |                  |                  |                   |                       |                         |
| Automjet blerë nga MB                        |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  |                  | 437,500           |                  |                  |                  |                   |                       |                         |
| Vend-parkim i hapur në Vlorë                 |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  |                  |                   |                  |                  | 700,550          |                   |                       |                         |
| Njësi shërbimi nr. 3 & 4, Selitë, Tiranë     |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                   | 811,620               |                         |
| Automjet Mercedes Benz 220                   |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                   |                       |                         |
| Ndryshim likuiditeti                         | 0                | 3,012,159        | -318,641         | -485,070          | -861,133         | -36,007          | 312,828          | 504,761          | -645,306         | 569,354           | 169,451          | 390,214          | 604,477          | -2,053,144        | 1,420,896             | -107,971                |
| <b>TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR</b>           | <b>0</b>         | <b>3,012,159</b> | <b>2,693,518</b> | <b>2,208,448</b>  | <b>1,347,315</b> | <b>1,311,308</b> | <b>1,624,136</b> | <b>2,128,896</b> | <b>1,483,590</b> | <b>2,052,944</b>  | <b>2,222,395</b> | <b>2,612,609</b> | <b>3,217,085</b> | <b>1,163,942</b>  | <b>2,584,838</b>      | <b>2,476,867</b>        |
| <b>DETYRIME</b>                              | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>-800,756</b>   | <b>-607,182</b>  | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>0</b>         | <b>2,082,150</b> | <b>-1,383,000</b> | <b>-978,040</b>  | <b>-560,840</b>  | <b>-280,220</b>  | <b>-1,689,995</b> | <b>0</b>              | <b>0</b>                |
| Detyrim ndaj shoqërisë ndërtuese             |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  | 2,082,150        | -1,106,400        | -698,600         | -280,420         |                  |                   |                       |                         |
| Hua ndaj kunatit F. Ç.                       |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  |                  | -276,600          | -279,440         | -280,420         | -280,220         | -275,300          |                       |                         |
| Dhënë vëllezërve nga tërheqjet e depozitave  |                  |                  |                  | -800,756          | -607,182         |                  |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  | -1,414,695        |                       |                         |
| <b>PASURI NETO</b>                           | <b>4,549,004</b> | <b>3,331,244</b> | <b>-173,301</b>  | <b>461,026</b>    | <b>-108,611</b>  | <b>-36,007</b>   | <b>312,828</b>   | <b>1,065,384</b> | <b>2,130,894</b> | <b>2,389,854</b>  | <b>1,147,491</b> | <b>951,054</b>   | <b>1,585,247</b> | <b>-363,148</b>   | <b>2,232,516</b>      | <b>-107,971</b>         |
| <b>Të ARDHURA dokumentuar</b>                | <b>2,861,099</b> | <b>879,759</b>   | <b>1,123,587</b> | <b>1,059,700</b>  | <b>1,905,337</b> | <b>2,157,647</b> | <b>2,260,070</b> | <b>2,460,645</b> | <b>2,579,211</b> | <b>2,976,655</b>  | <b>2,140,281</b> | <b>2,134,333</b> | <b>3,067,284</b> | <b>810,727</b>    | <b>2,084,002</b>      | <b>2,918,020</b>        |
| Të ardhura SR vertetuar                      | 1,992,202        | 442,464          | 658,875          | 592,168           | 1,130,755        | 1,180,767        | 1,282,925        | 1,514,179        | 1,605,625        | 1,954,631         | 1,166,061        | 915,717          | 1,266,847        | 604,061           | 350,279               | 2,573,575               |
| Të ardhura BSH vertetuar                     | 868,897          | 437,295          | 464,712          | 467,532           | 774,582          | 976,880          | 977,145          | 946,466          | 973,586          | 1,022,024         | 974,220          | 1,218,616        | 1,800,437        | 206,666           | 1,733,723             | 344,445                 |
| <b>SHPENZIME</b>                             | <b>3,041,637</b> | <b>534,053</b>   | <b>375,456</b>   | <b>548,514</b>    | <b>438,228</b>   | <b>763,951</b>   | <b>615,747</b>   | <b>1,078,830</b> | <b>1,020,258</b> | <b>1,254,424</b>  | <b>1,122,213</b> | <b>961,385</b>   | <b>1,482,037</b> | <b>1,173,875</b>  | <b>499,421</b>        | <b>1,403,229</b>        |
| Shpenzime jetese                             | 2,145,337        | 375,456          | 375,456          | 438,228           | 438,228          | 492,354          | 546,480          | 546,480          | 546,480          | 546,480           | 564,096          | 564,096          | 879,992          | 897,104           | 313,456               | 626,912                 |
| Shpenzim për legalizim objekti               |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  |                  | 205,587           |                  |                  |                  |                   |                       |                         |
| Shpenzim për zhdoganim automjeti             |                  | 158,597          |                  |                   |                  |                  |                  | 237,434          |                  |                   |                  |                  |                  |                   | 179,201               |                         |
| Shpenzime arredimi                           | 800,000          |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  | 200,000          | 200,000           | 450,000          | 200,000          | 400,000          |                   |                       | 500,000                 |
| Shpenzimi për arsimimin e fëmijëve           |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  | 190,000           |                       | 190,000                 |
| Shpenzim qiraje zyre                         |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  | -40,000           |                       | 50,000                  |
| Shpenzime udhëtimi                           |                  |                  |                  | 110,286           | 0                | 271,597          | 69,267           | 294,916          | 262,579          | 287,757           | 93,491           | 192,789          | 184,945          | 30,971            | 6,764                 | 20,967                  |
| Shpenzim për blerje trualli                  | 96,300           |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                   |                       |                         |
| Shpenzim për siguracion automjeti            |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  | 11,199           | 14,600            | 14,626           | 4,500            | 17,100           | 15,800            |                       | 15,350                  |
| Analiza dokumentuar                          | -4,729,542       | -2,985,538       | 921,432          | 50,160            | 1,575,720        | 1,429,704        | 1,331,495        | 316,432          | -571,941         | -667,623          | -129,423         | 221,895          | 0                | 0                 | -647,935              | 1,622,762               |
| CASH në lekë                                 |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                  |                  |                   |                  |                  | 710,487          | 1,075,500         | 1,400,000             | 900,000                 |
| <b>DIFERENCA E PA MBULUAR</b>                |                  |                  |                  | <b>-9,732,002</b> |                  |                  |                  |                  |                  |                   |                  |                  |                  |                   |                       |                         |

108. Në përfundim, lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe nuk ka pasur mjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e pasurive së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, dhe të pikës b, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, duke mos arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, e kësajsoj në këtë rast duhet aplikuar pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

109. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, është përcjellë në Komision një raport me nr. \*\*\* prot., datë 27.10.2017, për subjektin e rivlerësimit, me të cilin ishte konstatuar përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit Astrit Halilaj.

110. Me shkresën e datës 2.6.2021 – në vijim të kërkesës për përditësimin e informacionit shtesë të datës 24.5.2021 – Komisionit i është bërë me dije se nuk janë evidentuar vepra kriminale nga z. Astrit I. Halilaj. Gjithashtu, Komisionit i është komunikuar nga DSIK-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2021, se raporti i sipërcituar për këtë subjekt është deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.2.2021, të KDZH-së.

111. Në vijim të komunikimeve të mëtejshme me organet ligjzbatuese dhe përgjatë hetimit administrativ të kryer nga Komisioni nuk kanë rezultuar informacione apo fakte/rrethana të reja për subjektin e rivlerësimit, lidhur me këtë kriter, që mund të ngrinin dyshime mbi besueshmërinë e konkluzionit të arritur nga DSIK-ja.

112. Nisur nga sa më sipër, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

## **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

### **Lidhur me analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLP-ja**

113. Raporti është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale dhe miratuar nga KLP-ja me nr. \*\*\* prot., datë 16.11.2021, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

114. Ky raport i ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: formularit të vetëdeklarimit, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

### **Rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni**

115. Komisioni, në bazë të neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka analizuar raportin e KLP-së, si dhe dokumentacionin e përcjellë nga ky institucion, ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës, duke analizuar dosjet profesionale të administruara për këtë qëllim.
116. Pasi u njoh dhe analizoi dokumentacionin e depozituar nga KLP-ja, mbi të cilin ishte hartuar raporti i vlerësimit profesional për këtë subjekt rivlerësimi, Komisioni, për sa i përket tri dokumenteve të vëna në dispozicion nga subjekti, të llojit vendim për pushimin e çështjes, vendim për marrjen e personit të pandehur dhe konkluzione përfundimtare, si dhe në pesë dosjet e përzgjedhura me short të llojit vendim pushimi/mosfillimi të procedimeve penale dhe kërkesë për gjykim – nuk ka konstatuar problematika të natyrës procedurale, lidhur me vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

### **Lidhur me ankesat e paraqitura ndaj subjektit në KLP**

117. Nga verifikimi i të dhënave nga burimet arkivore në Prokurorinë e Përgjithshme ka rezultuar se ndaj prokurorit Astrit Halilaj nuk ka masë disiplinore. Nga përgjigjet e përcjella nga prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë të rretheve evidentohet se nuk ka të dhëna apo *indicie* të ardhura nga agjencitë ligjzbatuese për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshime në kuptimin penal dhe atë të cenimit të figurës së subjektit të rivlerësimit për përfshirje të drejtpërdrejtë ose indirekt në veprime të dyshimta. Mbi bazën e kërkesës për informacion, Prokuroria e Përgjithshme bën me dije se nga kontrolli i ushtruar në Regjistrat e Ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, për periudhën 2006 – 2018, ka rezultuar se ka një ankesë, e cila trajtohet sa më poshtë.
118. Praktika nr. \*\*\* e vitit 2017, regjistruar pas ankesës së shtetasit Gj. M., i cili në vitin 2012 ka bërë kallëzim penal ndaj disa inspektorëve të INUK Velipojë, duke pretenduar se prej tyre ishin kryer veprime në kundërshtim me ligjin, në këtë mënyrë duke konsumuar veprën penale “shpërdorim detyre”. Pasi është regjistruar si procedim nga ana e organit të akuzës, nga prokurori janë kryer veprime hetimore në përfundim të të cilave është vendosur pushimi i hetimeve. Sa ka rezultuar, shtetasi ka ankimuar vendimin e prokurorisë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Gjykata e Apelit Shkodër e kanë prishur vendimin duke i lënë detyrë prokurorisë vijimin e hetimit.
119. Ky shtetas ka pretenduar se prokurori Astrit Halilaj nuk i kishte dhënë asnjë informacion mbi vijimin e hetimit dhe, ndër të tjera, ka paraqitur pretendimin për hetimin e pamjaftueshëm të prokurorit, subjekt rivlerësimi, dhe të prokurorëve të tjerë, të cilët kishin trajtuar rastin. Ankesa është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Inspektimit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Prokuroria e Përgjithshme, nëpërmjet shkresës nr. \*\*\* prot., datë 27.11.2018, drejtuar shtetasit ka bërë me dije se me ndryshimet e bëra në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë me ligjet nr. 76/2016 dhe nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Prokurori i Përgjithshëm nuk e ka më si kompetencë kontrollin e veprimtarisë hetimore të kryer nga prokuroritë e rretheve

gjqësore, prandaj për çdo pretendim lidhur me vendimmarrjen e prokurorëve duhet t'i drejtohen gjykatave pranë të cilave ata prokurorë ushtrojnë funksionet.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

120. Lidhur me ankesën e shtetasit Gj. M. të paraqitur nga ky i fundit në Prokurorinë e Përgjithshme të relatuar në relacion, në rubrikën “Të dhënat arkivore lidhur me masa disiplinore, ankesa dhe vlerësime”, pika 2, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se shtetasi Gj. M. ka bërë kallëzim ndaj fqinjit të tij Gj. Gj., duke e akuzuar se në tokën e kallëzuesit ka ndërtuar një stallë bagëtish pa leje, në vitin 2009, në fshatin \*\*\*, Velipojë, Shkodër. Kallëzuesi ka akuzuar edhe punonjësit e INV-it dhe INUK-ut se ndonëse kanë shkuar tek objekti pa leje nuk e kanë prishur atë për shkaqe subjektive, duke pretenduar se ata kanë kryer veprën penale “shpërdorim detyrë”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. Mbi këtë bazë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër është regjistruar dhe janë zhvilluar hetime të procedimit penal nr. \*\*\*. Pasi janë kryer hetime të plota, të gjithanshme dhe objektive me datë 30.10.2020 prokurori i është drejtuar gjykatës me kërkesë për *pushimin e çështjes penale*, sipas parashikimeve të neneve 328/1/b dhe 329/a të Kodit të Procedurës Penale, pasi fakti nuk parashikohej në ligj si vepër penale sipas parashikimit në nenin 248 të Kodit Penal. Me tej, subjekti ka shtuar se nuk ka dijeni për ecurinë e procedimit për arsye, se dosja është dorëzuar pasi ai ka qenë me leje afatgjatë pa pagesë nga KLP-ja, me datë 20.6.2021, për arsye shëndetësore dhe se nuk ka dijeni se cili prokuror është caktuar për ta ndjekur procedimin.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

121. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar (kopje të vendimeve nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2021 dhe nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2022, të ILD-së për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të paraqitura nga shtetasi Gj. M.) – Komisioni arrin në përfundimin se kjo ankesë i është nënshtruar verifikimit procedural nga ky institucion, si dhe për aq kohë sa është evidentuar fakti se nuk ka qenë subjekti i rivlerësimit prokurori që ka ndjekur çështjen në fjalë, prej vitit 2012, por ai është ngarkuar për vijimin e këtij hetimi në vitin 2016, nuk gjenden shkelje apo të dhëna të cilat mund të merren në konsideratë në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

## **DENONCIME NGA PUBLIKU**

122. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë paraqitur nga publiku gjithsej 4 denoncime, të cilat janë shqyrtuar së bashku me materialet përkatëse. Në vijim të analizimit të denoncimeve, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa akte/dosje hetimore dhe gjyqësore për të vlerësuar aspektin profesional të subjektit të rivlerësimit, nga ku ka rezultuar si vijon:

### **1. Denoncim/ankesë nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2021, i shtetasit G. B.**

123. Shtetasi G. B. akuzon prokurorin Astrit Halilaj, pasi ky i fundit ka dërguar për gjykim çështjen pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër me akuzën “vrasje me dashje”, duke pretenduar se në gjyqin e zhvilluar gjykata e ka ndryshuar akuzën për këtë çështje në “plagosje e rëndë me dashje” dhe se për këtë ka qenë dakord edhe prokurori Astrit Halilaj, sipas vendimit nr.



\*\*\*, datë 22.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Shtetasi pretendon se organi i prokurorisë nuk ka njoftuar palën për ndryshimin e akuzës, duke i mohuar të drejtën e ankimit dhe se organi i prokurorisë nuk ka kryer hetime të mëtejshme dhe nuk ka thirrur si dëshmitarë personat që kishin dijeni lidhur me autorin e ngjarjes, me qëllim favorizimin e autorit të vrasjes H. I. Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 4, duke i kërkuar shpjegime, në përgjigje të të cilit ky i fundit ka shpjeguar se procedimi penal nr. \*\*\* është regjistruar me datë 28.4.2020, në ngarkim të shtetasit H. I., i dyshuar për veprat penale “vrasje me paramendim e ngelur në tentativë” dhe “mbajtje pa leje të armëve në ambiente të hapura për publikun”.

124. Në përfundim të hetimeve të dyshuarit i është njoftuar akuza për veprat penale “vrasje me dashje e ngelur në tentativë” dhe “mbajtje pa leje të armeve në ambiente të hapura për publikun<sup>45</sup>”. Gjatë shqyrtimit të kërkesës për dërgimin e çështjes për gjykim, gjykata, bazuar në kërkesat e nenit 332/d të Kodit të Procedurës Penale, i ka kërkuar prokurorit që të bëjë korrigjimet e duhura për ndryshimin e kualifikimit të veprës penale nga “vrasje me dashje e ngelur në tentativë”, e parashikuar nga neni 76-22 i Kodit Penal në “plagosje e rëndë me dashje”, e parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal dhe mbi bazën e kërkesës së gjykatës është bërë edhe ndryshimi i kualifikimit duke e akuzuar përfundimisht të pandehurin H. I. për veprat penale “plagosje e rëndë me dashje” dhe “mbajtje e armëve pa leje në ambiente të hapura për publikun”. Në nenin 332/d të Kodit të Procedurës Penale parashikohet se: *“Kur gjatë seancës paraprake del se cilësimi juridik i faktit është i gabuar ose kur akuza nuk është formuluar në mënyrë të qartë dhe të saktë, gjykata fton prokurorin që të bëjë korrigjimet ose saktësimet e nevojshme. Në rast se prokurori nuk vepron, gjykata vendos t’i kthejë aktet. Ky vendim i njoftohet drejtuesit të prokurorisë”*.

125. Për ndryshimin e kualifikimit të veprës penale ka marrë dijeni edhe viktimja, shtetasi G. B., i cili është njohur në seancë gjyqësore me ndryshimin e kualifikimit të veprës penale, pasi ka qenë i pranishëm së bashku me mbrojtësin e tij<sup>46</sup>. Në përfundim të gjykimit nga prokurori është kërkuar deklarimi fajtor dhe dënimi i të pandehurit me 10 vjet burgim, ndërsa gjykata e ka dënuar të pandehurin me 7 vjet burgim<sup>47</sup>.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

126. Në lidhje me këtë denoncim/ankesë subjekti i rivlerësimit, përveç shpjegimeve të dhëna në pyetësorin nr. 4, ka sqaruar nëpërmjet prapësimeve se ndryshimi i kualifikimit ligjor të veprës penale është bërë në seancën gjyqësore nga gjyqtari i seancës paraprake, duke u bazuar në kërkesat e nenit 332/d/3 të Kodit të Procedurës Penale. Në të katër seancat gjyqësore ka qenë

<sup>45</sup>Përfundimi i hetimeve i është njoftuar edhe viktimës G. B. dhe mbrojtësit të zgjedhur prej tij.

<sup>46</sup>Lidhur me shkakun e ndryshimit të akuzës, sqarohet se: *“Ndryshimi i akuzës është bërë duke u bazuar në rrethanat e ndodhjes së ngjarjes, distancës dhe drejtimit të qitjes, afërsisë së autorit me viktimën, pjesët e trupit ku janë shkaktuar dëmtimet me armë zjarri, dhe në tërësi dinamika e zhvillimit të ngjarjes. I pandehuri i ka pasur të gjitha mundësitë për ta realizuar qëllimin kriminal të marrjes së jetës së viktimës, por ai me vullnetin e tij të lirë e ka ndërprere sulmin duke e lejuar që viktimja të largohet në këmbë nga vendi i ngjarjes, me gjithë plagët e marra në trup. Viktimja ka deklaruar se i pandehuri ka qenë aq afër me të sa që janë përleshur edhe fizikisht me njëri tjetrin. I pandehuri i ka pasur të gjitha mundësitë për të qëlluar viktimën në pjesë jetike të trupit si në zemër, kokë, etj., duke i shkaktuar vdekjen e menjëhershme, por ai e ka qëlluar në pjesën e djathtë të trupit, ku dy predha janë konstatuar në parakrahum e dorës së djathtë”*.

<sup>47</sup>Vendimi nr. 51-2021-3472, datë 28.6.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

i pranishëm viktima G. B., si dhe në seancën e datës 15.12.2020, kur gjykata ka kërkuar ndryshimin e kualifikimit të cilësimit juridik të veprës penale, kanë qenë të pranishëm viktima dhe mbrojtësi i zgjedhur prej tij av. S. A. Në seancën e datës 22.12.2020, ku prokurori ka kërkuar saktësimin e cilësimit juridik të veprës penale ka qenë i pranishëm viktima G. B., seancë në të cilën është bërë edhe shpallja e vendimit nga gjyqtari i seancës paraprake. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar si prove të re, katër proces-verbalet e seancave gjyqësore të administruara me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

127. Komisioni arrin në përfundimin se nga analizimi i dokumentacionit (procesverbaleve të seancave gjyqësore) ka rezultuar se denoncuesi G. B. ka qenë i pranishëm në të dyja seancat gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari paraprak kur i është komunikuar edhe ndryshimi i cilësimit të veprës penale. Më tej, kjo çështje ka kaluar për shqyrtim në themel të një gjyqtar tjetër, i cili me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.6.2021, ka disponuar mbi fajësinë e të pandehurit. Ky vendim është ankimuar nga i pandehuri në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila ka disponuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.3.2022, duke mos e pranuar ankimin e tij. Nga sa më sipër, pretendimi i ngritur nga ankuesi/viktima G. B. se nuk ka qenë në seancë gjyqësore dhe se nuk i është njoftuar ndryshimi i cilësimit të veprës penale kur është marrë vendimi për ndryshimin e akuzës nuk qëndron, pasi nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar e kundërta.
128. Trupi gjykues, duke vlerësuar përmbajtjen e denoncimit në fjalë në raport me sa ka rezultuar nga aktet dhe dokumentet e administruara, si dhe duke mbajtur në vëmendje shpjegimet bindëse dhe shteruese të paraqitura nga subjekti, arrin në përfundimin se nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionimit të tij, lidhur me këtë çështje dhe se pretendimet e denoncuesit nuk qëndrojnë.

### **2. Denoncim/ankesë nr. \*\*\* prot., datë 23.2.2021, i shtetasit A. B.**

129. Nëpërmjet këtij denoncimi pretendohen vendimmarrje të padrejta nga disa subjekte rivlerësimi dhe ndërmjet tyre është edhe prokurori Astrit Halilaj, i cili nga dokumentacioni në dispozicion rezulton se i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër *pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2019*, të ngritur nga gjyqtarja A. Ll., pasi bazuar në germën “a” të nenit 328/1 dhe nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale fakti penal nuk ekziston. Me kërkesën e sipërcituar është njohur edhe denoncuesi referuar praktikës në dispozicion. Komisioni nuk sheh *indicie* për thellimin e hetimit, pasi bëhet fjalë për një vlerësim të çështjes në themel, si dhe të elementeve të rezultuar nga hetimet e prokurorisë dhe për një vendim të pa kundërshtuar/ndryshuar nga organe të tjera. Gjithashtu, nuk rezulton se denoncuesi të ketë përshkruar shkelje specifike procedurale, të kryera nga subjekti i rivlerësimit.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

130. Lidhur me këtë ankesë, edhe pse subjektit nuk i ish kërkuar shpjegime, ai ka parashtruar se shtetasi A. B. është ankuar për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. \*\*\*, datë 12.11.2019, për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga nenet 186/1 dhe 186/3 të Kodit Penal. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, si dhe kryerjes së një hetimi të plotë

nga organi i prokurorisë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur pranimin e kërkesës së prokurorisë dhe pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal. Ankuesi A. B. nuk rezulton të ketë bërë ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë në datën 19.3.2021, kjo referuar shënimit të kryesekretarisë. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar si provë të re shkresën nr. \*\*\* prot., datë 10.6.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, si dhe kopjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 26.1.2021, të po kësaj gjykate.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

131. Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se shpjegimet e subjektit janë shteruese dhe se prej tij janë kryer hetime të plota dhe objektive, për sa kohë veprimtaria e subjektit është vlerësuar dhe konfirmuar edhe nga gjykatat përkatëse. Kësisoj nuk kanë rezultuar të bazuara pretendimet e këtij shtetasi në denoncimin në fjalë.

### **3. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 9.1.2020, anonim<sup>48</sup>**

132. Denoncuesi anonim ka përshkruar në denoncim lidhur me vendosjen e sekuestros preventive nga prokurori Astrit Halilaj në emër të shtetases A. D. dhe se vendosja e kësaj është bërë më kërkesë jo të ligjshme nga një tjetër subjekt rivlerësimi. Denoncuesi nuk përshkruan shkelje procedurale nga subjekti, por parashton faktin lidhur me një kërkesë në gjykatë të subjektit të rivlerësimit për sekuestron preventive<sup>49</sup>, të kërkuar nga ky i fundit në kundërshtim me ligjin.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

133. Lidhur me këtë ankesë subjekti ka shpjeguar se nga hetimi është provuar se shtetasja A. D. kishte falsifikuar vendimin nr. \*\*\*, datë 17.4.2001, të KKKP-së, Malësi e Madhe. Hetimet e kryera nga organi procedues kanë qenë të gjithanshme dhe objektive dhe kërkesa për vendosjen e sekuestros preventive ka qenë e bazuar në nenin 274 të Kodit të Procedurës Penale, pasi prona ishte përfituar mbi bazën e një dokumenti që provohet se është tërësisht i falsifikuar, pavarësisht faktit se për këtë veprë është parashkruar ndjekja penale sipas nenit 186 të Kodit Penal. Me të drejtë, gjykata ka vendosur sekuestron preventive mbi këtë pasuri, vendim i cili është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Shkodër.

134. Subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion si provë të re kopjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 25.5.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila, sipas kërkesës së organit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, e ka pranuar këtë kërkesë dhe ka vendosur sekuestron preventive ndaj tri pasurive, objekt gjykimi.

### **Vlerësimi i trupit gjykues**

135. Nisur nga shpjegimet e subjektit dhe nga shqyrtimi i vendimit të depozituar ka rezultuar se organi i akuzës ka vlerësuar se shitblerja e pasurive ishte bërë në kundërshtim me ligjin, pasi ishte bazuar mbi dokumentacionin e falsifikuar dhe, si e tillë, është çmuar e nevojshme në atë

---

<sup>48</sup>Letër e hapur, protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 9.1.2020, në Komision, referuar ligjit nr. 84/20116, neni 53 "Pjesëmarrja e publikut në denoncimin e fakteve".

<sup>49</sup>Komisioni e ka marrë edhe më parë në shqyrtim këtë denoncim dhe është shprehur me vendimin nr. \*\*\*, më 7.7.2021, B. H., paragrafi 59.

fazë shqyrtimi, vendosja e sekuestros preventive të pronave në fjalë. Kjo kërkesë është gjetur e drejtë dhe e bazuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodrës, që ka vendosur këtë masë, pasi çështja ka qenë ende në fazën e hetimeve paraprake.

136. Nga sa më lart, Komisioni vlerëson se nuk janë konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionimit të tij, lidhur me këtë çështje dhe se pretendimet e denoncuesit/ankuesit anonim nuk qëndrojnë për sa kohë kërkesa e subjektit ka qenë ajo e duhura dhe për sa kohë është miratuar/pranuar edhe nga gjykata dhe janë konstatuar shkelje procedurale apo hetime të paplota.

#### **4. Denoncim nr. \*\*\* prot., datë 27.5.2019, i shtetasit A. Gj.**

137. Shtetasi A. Gj. ka denoncuar prokurorin Astrit Halilaj për shpërdorim detyre, pasi ka marrë përsipër të hetojë çështjen, ku një nga personat e akuzuar është shtetasja V. D., gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe sipas tij, prokurori nuk ka garantuar barazinë para ligjit, me argumentin se ai, pra denoncuesi, nuk ka arritur të ankimojë vendimin për pamundësi ekonomike dhe se për këtë, ai i është drejtuar Prokurorisë pranë Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke i kërkuar mbrojtje ligjore, por këta të fundit nuk i kanë kthyer përgjigje. Referuar dokumentacionit të disponuar dhe të vënë në dispozicion ka rezultuar se prokurori Astrit Halilaj ka marrë vendimin “Për mosfillimin e procedimit penal” të datës 10.4.2018, pasi është regjistruar kallëzimi penal nr. \*\*\* mbi bazën e shkresës nr. \*\*\* prot., datë 23.3.2018, të Prokurorisë së Përgjithshme të ardhur për kompetencë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

138. Referuar shpjegimeve dhe dokumentacionit të administruar për këtë çështje, ka rezultuar se shtetasi A. Gj. ka paraqitur kallëzim në Prokurorinë e Përgjithshme, e cila e ka sjellë për kompetencë sipas nenit 78 të KPP-së, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër. Rezulton se, për të njëjtin fakt, ankuesi ka bërë kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila ka vendosur mosfillimin e procedimit për kallëzimin nr. \*\*\*, vendim i cili nuk rezulton të jetë ankimuar në gjykatë, sipas parashikimeve të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale. Duke qenë se fakti nuk parashikohej në ligj si vepër penale, por përpara një mosmarrëveshjeje me natyrë juridiko-administrative, bazuar në kërkesat e neneve 290/1/ç dhe 291 të KPP-së, është vendosur mosfillimi i procedimit penal, duke i dërguar për njohje kallëzuesit një kopje të vendimit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2018. Ankuesi nuk ka ushtruar ankim në gjykatë ndaj vendimit të prokurorit, sipas parashikimeve të nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti ka vënë në dispozicion kopje të vendimit të datës 10.4.2018, për mosfillimin e procedimit për materialin kallëzues nr. \*\*\*, datë 27.3.2018, me të cilën është njohur edhe kallëzuesi A. Gj., sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2018.

#### **Vlerësimi i trupit gjykues**

139. Nisur nga sa më sipër, duke shqyrtuar dokumentacionin e administruar dhe rrethanat konkrete, si dhe shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se kjo ankesë nuk është e bazuar, pasi referuar vendimit të mosfillimit datë 10.4.2018, për sa i përket materialit kallëzues nr. \*\*\*, të vitit 2018, nga prokurori janë kryer të gjitha veprimet hetimore. Gjithashtu, subjekti, pas verifikimit të kallëzimit të këtij shtetasi, bazuar në parashikimet ligjore të neneve 290/1/ç dhe

291 të Kodit të Procedurës Penale, ka vlerësuar se kanë ekzistuar shkaqe që nuk kanë lejuar fillimin e procedimit penal, pasi fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Kësisoj është vendosur mosfillimi i procedimit, duke ua njoftuar atë palëve, si dhe duke u bërë të ditur të drejtën e ankimit të këtij vendimi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.

140. Në konkluzion, Komisioni nuk ka konstatuar shkelje procedurale apo mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit në ushtrimin e funksionimit të tij lidhur me këtë çështje dhe se pretendimet e denoncuesit nuk gjenden të bazuara në fakte.

### **KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues, sipas parashikimit të germës “a”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësoi çështjen në tërësi, bazuar në provat e administruara, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Astrit Halilaj:

- a. Në lidhje me kriterin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme dhe nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Këto konstatime kualifikohen në parashikimet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e krijimit dhe deklarimit të pasurisë dhe, nisur nga sa më sipër, në këtë rast duhet të aplikohet pika 3 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
- b. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk ka rezultuar që subjekti i rivlerësimit të ketë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Astrit Halilaj ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- c. Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, trupi gjykues çmon se duke e parë në tërësi rivlerësimin e aftësive profesionale, për sa kohë nuk kanë rezultuar shkelje procedurale dhe/ose mosrespektim i të drejtave të palëve apo hetime të paplota apo të pakryera nga subjekti i rivlerësimit Astrit Halilaj, vlerëson se ka arritur një nivel kualifikues, sipas parashikimit të dispozitave ligjore përkatëse.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Astrit Halilaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga Komisioneri Publik dhe/ose subjekti i rivlerësimit 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në datën 30.6.2022.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Kryesuese**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Relator**

**Roland ILIA**  
**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*  
*Ertugena Sokoli*